

# Dimër i ashpër në Mokër, dëbora në Senisht deri në 1 m

*Dëbora blloki 20 fshatra e Mokrës në tre komunat e Pogradecit, në Vleçan, në Proptisht, në Trebinjë. Fundi i shkurtit ka sjellë përmirësime të motit e zhbllokim të situatës*

**E**dhe ky dimër ishte i vështirë për Mokrën. Dëbora që ra pa pushim për ditë të tëra solli situata të vështira në tre komunat e rrethit të Pogradecit, atë të Proptishtit, Velçanit e Trebinjës.

Kryetarët e komunave të këtyre zonave thanë se po përballen me vështirësi të shumta. Kreu i komunës së Velçanit, Ilir Mani, shprehet se në qendër të komunës dëbora ka kaluar mbi 70 cm, ndërkohë që në fshatrat më të thella, si: Bishnicë, Shpellë, Jollë, Senisht dëbora kalon mbi 1 metër trashësi dhe ato janë izoluar.

Por ai thotë se është tepër i shqetësuar për familjet e Mexhit, Mersin dhe Iljaz Elezit, të cilëve rrëshqitja e dheut u ka shkuar deri në themelet e shtëpive dhe janë në rrezik për jetën.

Mani tha se u kanë siguruar shtëpi të tjera për t'i zhvendosur, por ata ende nuk kanë lëvizur sepse kanë problemin e kasolleve të bagëtive, por gjithsesi jeta e tyre është në rrezik. Anëtari i këshillit të komunës, Ramazan Rapçe, thotë se përveç dëborës ata rrezikohen nga kopetë e ujërve që kanë zbritur nga malet përreth dhe sulmojnë bagëtitë e njerëzit që qarkullojnë në fshat.

E vështirë paraqitet gjendja edhe në



Burgu i Spaçit

ME RASTIN E 15-VJETORIT TË VDEKJES (SHKURT 1995 - SHKURT 2010)

## Si dhe përse u burgos Haki Slatina, "Martiri Demokracisë"

Speciale në faqet 4-5



**Krisje e shpirtit të hepuar në mote**

Intervistë me shkrimtarin Istref Haxhillari

FALENDERIM I VEÇANTË PËR Z.DHORI SPIROLLARI PËR SPONSORIZIMIN E PJESSHËM TË KËTJË NUMRI

PROF. AS. DR. SKËNDER ALIU ZBULON VLERAT DHE HISTORINË E KËRKIMEVE 47-VJEÇARE PËR KUFIJTË E QYTETËRIMIT TË VJETËR

**Qytetërimi i Pelionit të lashtë, historia e të fshehtat**



**Këngët**

Nga HYSEN FILJA \*





## Urim nga zemra me rastin e 60-vjetorit të lindjes së z. Zabit Cuku

Jemi një grup miqësh dhe shkoësh të zotit Zabit, nga vende të ndryshme të Shqipërisë dhe banojme në një pallat. Me punën e tij arriti të na bëjë "antarë" dhe lexues të gazetës Mokra. Me rastin e 60 vjetorit të ditëlindjes së zotit Zabit më 23 janar 2010 dëshira e jonë për ta uruar me një shkrim të shkurtër urimi në Gazetën Mokra

Në një ditë të zkonshme pushimi nga vetë Zabit morëm vesh ditëlindjen e tij dhe na bëri një ftesë të ngrohtë familjare. Ntyrisht sipas traditës Mirditore dhe Mokrake burrat kanë një shikim serioz dhe miratojnë të mirat dhe të bukura.

Dëshira për këtë takim familjar ishte e Erionit dhe vëllezërve të tij të cilët kishin vendosur, për këtë takim familjar. Edhe neve si shokë e miq e dinim që do të ishim në këtë takim që u organizua më 23 janar 2010 ora 11 në lokalin e Ushtarakëve në Tiranë.

Gëzim për neve dhe shumë të tjerë që ishin aty do të mbetet i në kujtesën tonë me mbresat dhe një këngësi të veçantë.

Në raste të tilla me shumë rëndësi ka emocionet me këngët vallet, humori, dhe mbresat që ngelen.

Gëzimi filloi duke, u dëgjua zëri i një këngëtarit strugar Skifter Etemi me një valle të kënduar me emocion "Lujma, Lujma Vallen O",

Në këtë moment pjesmarrësit u emocionuan, dhe u prekën kur panë se nga fundi i sallës doli një vajzë rreth 12-13 vjeçe e veshur me një kostum kombëtar të Rrajcës. Kjo shoqërohesh nga Etleva dhe Elsa, ishte e qeshur sikur të qe tamam çupë shqipitare e që nuk fliste asnjë fjale shqip, po vetëm kokën lart dhe qeshte. Në dorë mbante një tufë të madhe me lule shumë ngjyrshë të sjella nga Italia për gjyshin e vet Zabitin. Kjo ishte Alessia, mbesa e cila jeton në Bolonja të Italisë dhe kishte ardhur për festën e gjyshit familjarisht.

Këto u drejtuan për të dhënë lulet gjyshit kur në sallë shpërthyen emocionet, me duartkrokime po dhe me pika loti nga emocionet dhe atmosferën e bukur që u krijua. Gjyshi me shumë emocione sa nuk fliste dot me tufën e luleve dhe i shoqëruar nga Alessia, Etleva dhe Elsa kaluan në çdo tavolinë duke na përshëndetur dhe treguar një respekt të veçantë, me dorë në

zemër e lot në sy, falenderuan gjithë pjesëmarrësit me një urim gëzuar, gëzuar e gëzuar. Ky gëzim u pasurua me muzikë dhe valle sipas traditës Rrajcare ku nuk u mungon për asnjë moment.

U bë një përshëndetje nga Erioni djali i Zabitit i cili me shumë emocione i prerë nga falenderoi në emër të familjes për pjesëmarrjen duke uruar babanë, dhe pjesëmarrësit.

Muzika popullore ishte tepër e spikatur sipas krahinës e më gjërë, me këngë grash, valle dyshë e "Thikave" e kërcyer nga Zabitit me Hamiden ishte e mrekullueshme, serioze dhe burrnore, shumë e shume valle të tjera të Rrajcës që neve na lanë shumë mbresa dhe kënaqësi.

Gëzimi vazhdon me urime sipas dëshirave po dhe me përshëndetje, si Prenga nga Mirdita, Fadili nga Puka, Seferi nga Dibra, e të tjerë. Në këto urime ishte fjala e ngrohtë dhe urimi për miqësinë me familjen e madhe të Zabitit, ishte respekti vallzaror që është arritur në vite. Emocionues ishte përshëndetja e Zabitit dhe Bashkimit ku ne u quajtem si një familje e madhe që jemi mbledhur për të kënduar dhe kërcyer së bashku.

Në këtë gëzim u tregua dashuria, respekti vllazëror, ku për pesë orë nuk u pushua asnjë çast vallja, kënga e vallja. Sikur të mos ishin larg nga Rrajca ata nuk largoheshin nga salla, Urimet dhe dashuria për njëritjetrin ishin të pafundme, ishin preke, dhe shumë emocionuese.

Ne që ishim nga zona të tjera vërtet u emocionuam shumë me të gjithë pjesëmarrësit dhe për ne dukesh sikur ishim vërtet një familje e madhe dhe jetonim prej shume vitesh bashkë, Emocione dhe kënaqësi i dhanë takimit kolegët Ylli, Zenuni, dhe të gjithë miqtë pjesëmarrës Avniu, Shemsi e Tasha, Sela, etjerë. Urime të veçanta i dërgojmë nënës, Zabitit e cila na manihiti me vallen dhe këngët për moshën që kishte.

Me këtë rast ne si shokë e miq, përveç urimeve që bëmë në atë gëzim, e urojme gëzuar ditëlindjen me këtë shkrim të thjeshtë në gazetën Mokra faleminderit të gjithëve dhe gëzim të tjerë paçi.

Me respekt nga:

**Preng Reçi, Fadil Çoba, Behar Mara, Ylli Xhelili.**



## UDHËTIM NË MOKËR

Me rastin e emisionit më 30 janar 2010 "Udhëtim në Mokër" stafi i gazetës "Mokra" falenderon "TV "Koha" dhe gazetarin Genti HAZIZI

**Genti HAZIZI:** Shkojmë drejt Mokrës, dhe jemi në grykën e Katjelit, një rrugë e vështirë. Mokra një krahinë në Shqipëri ndër më të mëdhatë një vend i ashpër, por bujar, e mikëpritës. Gjithë Mokra ka mbi 40 fshatra, shtëpitë janë ndërtuar në shpatet e maleve.

**Fatmir LEKA:** Mokra gjeografikisht bën pjesë në rrethin e Pogradecit, kufizohet me rrethin e Librazhdit, Gramshit, Korçës, Pogradeci. Mokra është emëruar në dy Mokra, Mokra e Poshtme e Mokra e Sipërme. Në Mokrën e Poshtme bën pjesë Komuna e Velçanit e cila përfshin 8 fshatra, me 5016 banorë, Komuna e Proptishtit që përfshin 10 fshatra, me rreth 8218 banorë, Komuna e Trebinjës përfshin 15 fshatra.

**Genti HAZIZI:** Po shkojmë në zemër të mbretërisë ilire, në Selcën e Poshtme, në qendër të Pelionit, qytet ilir. Këtë vend historianët e kanë saktësuar se është qyteti Pelion, qendra e mbretërisë enkelenasve. Këtu janë muret monumentale ilire, një pikë e rëndësishme që lulëzoi dhe ra si të gjitha qytetet ilire.

**Haki BALLIU:** Në Pelion, janë gjurmët e ilirëve, këtu është gjetur gjeneza e mbretërisë ilire në vitin 1969. Kjo paftë tregon gjenezën ilire. Në këtë paftë janë padyshim elemente mitologjike, është paraqitur, një çast psikologjik nga triumfi i ilirëve mbi kundërshtarin.

**Përparim ISUFI:** Pelioni ka qënë një qendër kryesore e zonës, ka qënë në lulëzimin më të lartë. Ka qënë qendra e fisit ilir të enkelenasve, me mbret Bardhylin Plak e tjerë.

**Fatmir LEKA:** Mokra ka qënë qendra e enkelenasve, një nga qytetet më të mëdha, dhe sot ajo trajtohet si një qytet ilir, Pelion. Aty janë zhvilluar beteja me Filipin e II-të, Aleksandrin e Madh të Maqedonisë.

**Haki BALLIU:** Mbretëria e enkelenasve me Bardhylin Plak ka luftuar mbi tre breza me maqedonasit. Beteja më e madhe është bërë në vitin 359 para Krishtit e Filipit të II-të me Brdhylini cili pati humbje shumë të mëdha, u plagos në sy, dhe pas këtyre humbjeve bënë marrëveshje. Ndërsa Bardhyli i Ri në vitin 335 para Krishtit, luftoi me Aleksandrin e Madh, të cilin e detyroi të tërhiqej, dhe pas tre ditë luftimesh, në befasi Aleksandri e mori qytetin e Pelionit. Ndihi ma e mbretit të taulantëve Glauk bëri që fitorja të jetë e Klitit. Aleksandri i Madh në këtë betejë u plagos, dhe unë e kam trajtuar se Aleksandri u dukë i vogël në Pelion.

Pelionin e humbi rëndësinë e tij gjatë dyndjeve sllave në shekullin e 6-të pas Krishtit, 547-548, u bënë shkatërrime të tmerrshme në të gjithë Ilirinë, duke marrë e kthyer në skllëvër të gjithë ata që delnin përpara.

Focat ushtarake u larguan në ushtrinë biznatinë, tregëtarët u larguan, ndërsa ushtria brizante me Justianin, mori shumë ushtarë.

**Genti HAZIZI:** Urat e Treziut, Golikut tregojnë degëzimet e rrugës Egnatia, që shkante në Shpella, Opar, Voskopojë.

Lumi i Shkumbinit është i mbushur me mullinj me ujë, por tani e kanë humbur leverdine ekonomike, janë zevendë-

suar me ata me rrymë elektrike.

**Përparim ISUFI:** Në lumin Shkumbin dhe përrenjtë kanë qënë ndër-tuar mullinj me ujë, në çdo 400-500 metra ka qënë një mulli, në çdo fshat ka pasur mullinj, Goliku, Kriçkova, Sopotina, Slabinja, Çezma, Hondishti, Llënga e tjerë. Ata ndërtoheshin nga një çift gurësh të mëdhenj, që nxirreshin në Zall-Torrë, dhe transportoheshin me shumë vështësi deri tek vendi i ndërtimit të mullirit

**Genti HAZIZI:** Emri Mokër, rrjedh prej këtyre gurëve të rëndë me emër mokër. Ata merreshin shumë larg, dhe kur dy vëllezër u ndanë, njëri guri i poshtëm dhe tjetri guri i Sipërm, ndaj quhet Mokra e Poshtme dhe Mokra e Sipërme.

**Përparim ISUFI:** Emrat e mullinjëve ishin sipas fiseve. Si mulliri i Sinanit, nga fshati Slabinjë, që ka punuar para disa vjetësh Nazar Sinani, i cili u nda nga jeta në vitin 2008. Mullinj ka në çdo fshat.

**GENTI HAZIZI:** Jemi në qendrën e komunës Proptisht, lagjia e poshtme ka më shumë gjallëri e lëvizje. Është vendosur administrata e Komunës, me një numër infrastrukture.



**FATMIR LEKA:** Fshatart që janë prekur nga emigracioni më shumë ka qënë Bari i Bardhë, Slatina, Homezhi, ndërsa fshatrat që janë prekur më pak nga emigracioni janë fshatart Vërrit, Proptisht, Kriçkovë, e Slabinjë. Natyrisht pas vitit 2009, emigracioni është ngadalësuar, dhe po kthehen disa në vendlindje. Në komunën Velçan, është më i theksuar kthimi, nga emigracioni pasi aty ka një klimë të mirë, ka livadhe, ka pyje e tjerë.

E veçanta është se në këtë komunë, Velçan, në fshatin Bishnicë tre familje durrësake kanë blerë shtëpi dhe gjatë verës kalojnë atje pushimet.

Feja e Mokrës është myslimane, por disa fshatara si Povelani, Podozhani, Llënga janë me fe ortodokse. Kjo krahinë është dalluar për grupe folkorike, të cilat kanë marrë pjesë në festivalin e Gjrokastërës siç ka qënë ai i Kriçkovës, Rodokalit dhe të tjerë.

**Genti HAZIZI:** Në fshatin Kriçkovë, takojmë Fejzullah Fejzollarin, një njeri që i dëgjohej fjala tek gjithë banorët.

Fejzullah Fejzollari: Mokra ka qënë bujare e mikëpritëse, prituri dhe pritëse. Ka pasur shumë burra të respektuar, natyrisht ne i dëgjonim ata. Edhe rinia duhet të na dëgjojë neve.

**Genti HAZIZI:** Fshati Vërrit, është një fshat i bukur dhe i pastër. Po largohemi me kujtimet më të mira nga Mokra.

Faleminderit Mokër!  
**Përgatiti: Zenun FERO**  
Marrë me shkurtime nga TV "Koha"  
30 Janar 2010



# Dimër i ashpër në Mokër, bora në Senisht deri në 1 metër

*U bllokuan 20 fshatra e Mokrës në tre komunat e Pogradecit. Fundi i shkurtit ka sjellë përmirësime të motit e zhbllokim të situatës*

Edhe ky dimër ishte i vështirë për Mokrën. Dëbora që ra pa pushim për ditë të tëra solli situata të vështira në tre komunat e rrethit të Pogradecit, atë të Proptishtit, Velçanit e Trebinjës.

Kryetarët e komunave të këtyre zonave thanë se po përballeshin me vështirësi të shumta. Kreu i komunës së Velçanit, Ilir Mani, shprehet se në

qendër të komunës dëbora ka kaluar mbi 70 cm, ndërkohë që në fshatrat më të thella, si: Bishnicë, Shpellë, Jollë, Senisht dëbora kalon mbi 1 metër trashësi dhe ato janë izoluar.

Por ai thotë se është tepër i shqetësuar për familjet e Mexhit, Mersin dhe Iljaz Elezit, të cilëve rrëshqitja e dheut u ka shkuar deri në themelet e shtëpive

dhe janë në rrezik për jetën.

Mani tha se u kanë siguruar shpëtim të tjerë për t'i zhvendosur, por ata ende nuk kanë lëvizur sepse kanë problemin e kasolleve të bagëtive, por gjithsesi jeta e tyre është në rrezik. Anëtar i këshillit të komunës, Ramazan Rapçe, thotë se përveç dëborës ata rrezikohen nga kopetë e ujërve që kanë zbritur nga malet përreth dhe sulmojnë bagëtitë e njerëzit që qarkullojnë në fshat.

E vështirë paraqitet gjendja edhe në komunën e Mokrës në Trebinjë. Kryetari i saj, Gjergji Buzo, tha se Llënga, Hondishti, Çezma e madhe dhe Çezma e vogël janë prej disa

ditësh të izoluar dhe dëbora ka shkuar mbi 80 cm.

Por situatë e vështirë është edhe në krahinën e thellë malore të Gorës. Kryetari i komunës së Dardhasit, Rushan Çela, thotë se prej disa ditësh qëndrojnë të izoluar fshatra, si: Osnati, Niça, Dërdusha, Lekasi dhe Grunjasi. "Fatmirësisht, - thotë ai, - nuk kemi pasur ndonjë problem shëndetësor, pasi trashësia e dëborës në këto fshatra kalon mbi 80 cm".

Moti i keq dhe dëbora kanë ndërprerë herë pas here qarkullimin rrugor në Qafë -Ploçë. Probleme ka pasur me aksin rrugor Pogradec -Qafë -Thanë ku dëbora kalon mbi 35 cm dhe kalimi bëhet vetëm me zinxhirë dhe rruga është shumë e rrezikshme.

## NE BOTËN E MADHE TË DASHURISË NJERËZORE KU KRIJIMET REFLEKTOJNË JETË DHE HISTORI...

Nga Spase THANASI

Mozaiku i gazetës "Mokra,, në 11 vjetorin e saj është si një kristal që shkëlqen me ngjyra të ndezura në natyrën e ashpër malore të Mokrës ku burojnë ngjarje e rrëfime historike të jetës...

E parë në konturimin artistik ajo është një vepër e bukur e një ekipi gazetarësh, poetësh e shkrimtarësh që gjithsecili do të kishte zili jo vetëm për prurjen e pandërprerë të materialeve interesante, por edhe për ngarkesën funksionale të shpërndarjes së faqeve të gazetës dhe të shoqërimit me fotografari konkrete, dhe pse kostoja e botimit është e papërfillshme...

Është shpirti, pasioni dhe përpjekja e mundshme e stafit dhe botuesit të gazetës zotin Flori Slatina, e redaktorëve Haki Balliu, Zabit Cuku, Zenun Fero e shumë të tjerë që e bëjnë gazetën një model, një oaz të pastër burimor të historisë së lashtë dhe të kohës moderne, një përtëritës të traditës kulturore e folklorike të zonës nëpër breza.

I uroj gazetës jetëgjatësi, vazhdimësi dhe shpërthim frymëzues në arteret e tokës së moçme mokrare!

Urime 100-vjeçare dhe mbarësi !

Festa e gazetës suaj në këtë 11 vjetor është bukuria shpirtërore e krijimeve që e bëjnë penën letrare të artë. Është një dashuri e përjetim për peisiazhin e gjërë të vendlindjes, një kronologji historike e pandërprerë në jetën e brezave. Është një dëshmi e rrjedhjes letrare që ka shoqëruar gjithë pamjen e Mokrës, me simbolikën e Pelionit që është vërtetë një thesar kulturor e arkeologjik, që nuk ka vlerë për tu çmuar...

Nuk ka mbarim edhe shpërthimi frymëzues i krijuesëve që është si një trung i gjelbër artistik me mijëra vezullime e dashurie në pentagramin e kohës.

Për Mokrën dhe mokrarët gazeta është një përmendore dhe sfondi i saj gjithë shkëlqim në duart e tyre.

Le ta zbukurojmë përpara lexuesëve pëlhurën festive të këtij 11 vjetori !

Le të bëhemi të gjithë pjesë e zemrës krijuese !

Le të shpërndajmë gjithëandë nëpër Shqipëri lumturinë e krijimtarisë në faqet e gazetës "Mokra,, që është një organ i lexueshëm e i mirëpritur me kënaqësi.

Urime dhe vetem Urime .....



ME RASTIN E 15-VJETORIT TË VDEKJES (SHKURT 1995 - SHKURT 2010)

# Si dhe përse u burgos Haki

Nga Flori SLATINA

Në këtë shkurt mbushen plot 15 vjet nga vdekja e njërit prej martirëve të demokracisë, legjendës apo Mandelës së Shqipërisë, Haki Slatinës (Haki Isufit), i cili sfidoi diktaturën komuniste dhe vuajti plot 36 vjet në burgjet famëkeqe të diktaturës më të egër. Hakiu u nda nga jeta në shkurt të vitit 1995, në moshën 67-vjeçare, ku gjysmën e saj e kishte jetuar nëpër biruca e kampe pune nga më të rëndët. I lodhur, i vuajtur dhe pse jo, i pakënaqur apo i zhgënjyer, ai mbylli sytë në një ditë të ftohtë shkurti, për t'u përcjellë me respekt e nderime të mëdha nga kolegë, miq, familjarë e bashkëvujtës të tij. 15 vjet më pas, ende jehon fama dhe patriotizmi i tij. Bashkëvujtës, me lot në sy kujtojnë Haikun, si një trim dhe një njeri që nuk e theu dot regjimi. Është shkruar për të, është përmendur, por asnjëherë nuk është bërë publike vërtet aktiviteti dhe qëndrimi i tij burror nëpër burgje. Përtej hiperbolave, apo tregimeve folklorike ky shkrim do të nxjerrë në pah ato veti, atë qëndrim dhe, mbi të gjithë atë padrejtësi të regjimit si dhe vizionin dhe largpamësinë e Hakiut, si një njeri ndryshe, që nuk bëri dot kompromis me lirinë.

\*\*\*


Në Arkivin e Ministrisë së Brendshme gjenden disa dosje për gjykimin, dënimin dhe aktivitetin e Hakiut. Të grupuara në tre dosje të mëdha, të cilat përkujtojnë me tri dënimet e tij, 1949, 1955, 1975, nga dënimi i parë në vitin 1949 dhe deri tek dosja hetimore e vitit 1974-1975 në dënimin e tretë. Ai regjim ishte kriminel dhe, kur e shikon te se të burgosurit po i mbaronte afati i burgut, në rastin më të mirë kur nuk të kishte pushkatuar, e dënonte përsëri. Brenda në burg kryheshin hetime, seanca të gjata, kërcënime e tortura dhe pastaj jepej vendimi. Le ta nisim shkrimin nga "Dosja 5732-A", e vitit 1955.

\*\*\*

Në 4 shkurt 1955, u dha vendimi për dënimin e dytë të Haki Isufit. Ai u gjykua dhe u dënua së bashku me Xhevit Isufin, Haki Metën dhe Veis Metën. Kryetari i Gjykatës Speciale, Gjeneral Major Delo Balili, në vendimin e marrë në lokalit të Drejtorisë së Punëve të Brendshme në qarkun e Tiranës, e dënoi Haki Slatinën me 25 vjet heqje lirie, punë të detyruar dhe heqje të të drejtave. Ndërsa Xhevitin me 20 vjet dhe Veisin dhe Haki Metën me nga 15 vjet. Po çfarë kishin bërë, përse akuzoheshin dhe u dënuan?

Sipas vendimit, thuhet: "Haki Isufi, i biri i Hysenit dhe Adiles, i datëlindjes 1928, lindur dhe banues në katundin Senisht, me profesion bujk, me arsim autodidakt, me gjendje familjare i pamartuar, i paraburgosur më 13 shtator 1954 dhe i akuzuar me akt-akuzën e prokurorisë speciale, të parashikuara nga neni 24 i R.P.S.H. (Neni i arratisjes, shënim i red).

Xhevit Isufi, i biri i Hysenit dhe i Dudies, i datëlindjes 1922, lindur dhe banues në katundin Senisht, me profesion bujk, me 2 klasë shkollë, i martuar, i paraburgosur më 13 shtator 1954, etj, pra të dy janë arrestuar në të njëjtën ditë, më 13 shtator 1954, ndërsa dy të tjerët, Haki dhe Veis Meta



më pas, më 27 tetor 1954, akuzohen "të pandehurit Haki Isufi, Xhevit Isufi, Haki Meta, Veis Meta, në kontakte të vazhdueshme me njëri-tjetrin, kanë rënë në marrëveshje për të tradhtuar atdheun dhe për të shkruar në një shtet armik. Në korrik të vitit 1954, pasi Hakiu kishte dalë nga burgu takohet me të pandehurin Haki e Veis Meta, me të cilët bisedon për t'u arratisur në Greqi dhe me vete do të merrnin edhe Xhevit Isufin, i cili e kishte dhënë aprovimin për t'u arratisur që në vitin 1952. Duke qenë të vendosur për t'u arratisur, që të katër të pandehurit në shtator të vitit 1954, të nxitur nga i pandehuri Haki Isufi, në mbledhjen që bëjnë së bashku vendosin të arratisen në Greqi, qëllimin e ikjes do ta realizonin pasi i pandehuri Haki Isufi të rregullonte disa baza që kishte në Korçë. Në këtë mbledhje u caktuan edhe parullat dhe vendi ku do takoheshin. Këtij qëllimi kriminal të pandehurit nuk e arritën se në çastin final u kapën nga organet e sigurimit."

Kështu, pasi një gjyqi të shpejtuar, Hakiu u dënua me 25 vjet burg, si organizator, ndërsa të tjetër me dënime më të vogla.

Në seancat e vazhdueshme të pyetjeve përballë hetuesit Hakiu nis rrëfimin e tij edhe një herë për gjendjen e tij, familjen dhe rrethanat e "krimit". Seanca e parë e pyetjeve zhvillohet në 9 nëntor 1954. Hetuesi Gaqo Meçi merr në pyetje të pandehurit Haki Isufi, i cili nis rrëfimin e tij kështu:

"Quhem Haki Isufi, i biri i Hysenit dhe Adiles, lindur në 1928 dhe banues në Senisht të Pogradecit. Me shtetësi dhe kombësi shqiptare, me arsim autodidakt, me profesion bujk. Rrjedh nga një familje e mesme fshatare. Kam në pronësi 37 dynym tokë, 25 kokë bagëti, një ka dhe një mushkë. Shtëpinë e kemi pasur vazhdimisht tonën. Nuk jemi prekur nga reforma. Nuk ka njeri nga të familjes të jetë dënuar, pushkatuar apo internuar, jashtë shtetit, i arratisur, etj..."

Familja jonë përbëhet nga 10 vetë: 1. Babai Hysen, vjeç 55, 2. Nëna Adile Isufi, vjeç 52-53, 3. Osman Isufi, vëllai, vjeç 22, 4. Shefqet Isufi, vëllai, 20 vjeç, 5. Bexhet Isufi, vëllai, 18 vjeç, 6-7, vëllezërit Sami dhe Feridon Isufi, 14 dhe

12 vjeç, 8. Hajri Isufi, motra, 24 vjeç, 9. Barie Isufi, motra, vjeç 11, 10. Sheqere Isufi, gjyshja, vjeç 80. Kam edhe një vëlla më të madh, 35 vjeç Faik Isufi, ky është familje më vete. Është martuar me Sanije Isufin nga Lakteshi dhe ka tre fëmijë, më i madhi 10 vjeç. Kam edhe tri motra të martuara: 1. Adivije Cenka, vjeç 33, martuar me Beqo Cenken nga Kotodeshi, 2. Sabire Çekrezi, vjeç 31, martuar me Mersin Çekrezin nga Stravaj, 3. Sanije Shahini, vjeç 29, martuar me Nevruz Shahinin nga katundi Sposen i Gramshit.

Unë deri në vitin 1942 kam qenë pranë familjes, bari me bagëti dhe bujk për rreth 14 vjet. Në këtë kohë doli „Çeta e Mokrës”, dhe unë u hodha partizan me këtë çetë, ku kam qëndruar deri në dhjetor të vitit 1943. Nga dhjetor i i 1943 deri në prill 1944 qëndrova në fshat i fshehur, së bashku me Astrit Çollakun, që sot është n/kryetar i komitetit ekzekutiv të rrethit të Pogradecit. Në prill të vitit 1944 u hodha me Brigadën e Parë ku qëndrova deri në korrik të vitit 1946, kur u çmobilizova për shërbimin ushtarak. Prej korrikut 1946 deri në nëntor 1947 qëndrova pranë familjes me bujqësi. Në nëntor 1947 shkova në një kurs në Tiranë për kooperativë. Kur u ktheva në maj 1948 u emërova drejtor i kooperativës së shitblerjes. Për dy muaj në kooperativën e katundit Rrajcë dhe më pas në kooperativën e Çerravës ku qëndrova deri në dhjetor 1948. Në këtë kohë unë së bashku me Aqif Jeminin, nga Starova por banon në Pogradec, u arratisëm për në

Jugosllavi ku qëndruam për 12 ditë dhe më pas u kthëm pas që të dy në Shqipëri, u dorëzuam. Unë u dënova me 4 vjet si armik i popullit dhe një vit si ordiner pasi në arkën e kooperativës mungonin disa të holla, kur ika unë. Në burg qëndrova deri në 2 janar të vitit 1954. Në këtë kohë u lirova dhe qëndrova pranë familjes si i sëmure, deri tani në tetor të vitit 1954, kur u arrestova përsëri nga organet e sigurimit."

## Si ishte e vërteta e arratisjes dhe si erdhi dënimi i parë

Sipas dosjes hetimore nr. 1430 - A, thuhet: "... të pandehurit Aqif Jemini dhe Haki Isufi e kanë pranuar që u arratisën në Jugosllavi më datën 4 dhjetor 1948. Ata kalojnë kufirin dhe shkojnë në Kalishtë tek Haxhi Kalishti, i cili i dorëzon tek organet e sigurimit. Ardhja e tyre në Shqipëri është bërë mbasi janë kaluar nga ana e agentëve jugosllavë në kufi, e më vonë pas disa ditësh janë dorëzuar tek organet e sigurimit shqiptar. Meqë faji i tyre parashikohet i dënueshëm, ata dënohen me 5 vjet heqje lirie."

Në mbrojtjen që i ka bërë avokat Mihal Furxhiu, Haki Isufit, thuhet se i pandehuri Haki ka qenë i frikësuar nga mosmarrëveshja dhe moskuptimi që ka pasur me një superior, nga i cili varej. Duke marrë parasysh se është njeri pa shkollë dhe i ri (sapo kishte mbushur 20 vjeç) dhe se nuk paraqet rrezikshmëri shoqërore dhe se nuk ka dhënë

# Slatina, "Martiri i Demokracisë"

informata me karakter politik, si dhe dorëzimin e tij vullnetarisht në organet e sigurimit, ju lutem, në emër të mbrojtës t'i jepet një dënim më i lehtë."

Por kjo nuk u mor parasysh. Dënim u vuaj i gjithë dhe më 2 janar 1954 Haki doli nga burgu i parë e u kthye në fshat, në një gjendje të keqe shëndetësore dhe mjaft i dëshpëruar dhe i lodhur.

Ai kishte bërë luftën, kishte luftuar për atë pushtet, i cili u vuri prangat.

I dënuari tjetër Aqif Jemini thotë në hetuesi: "Kur vendosëm të ikim në Jugosllavi, nuk ka pasur dijeni njeri tjetër, vetëm unë dhe Haku. Muarëm rrugën dhe shkuan për në Shkallë të Rrajcës se rrugën e dinim se kishim shkuar që në kohën e Italisë për në Strugë. Kur kaluam kufirin rojet nuk na panë fare dhe ne u drejtuam për në katundin Kalishtë, në shtëpi të Haxhi Kalishtit, me nja dy sahat natë. Kur vamë në shtëpi, Haxhi Kalishti na e hapi derën dhe na futi brenda dhe ne i treguam për arratisjen. Ai na tha se nuk keni bërë mirë. Haxhi Kalishti, si u bë ditë, na shpuri në shtab të policisë dhe iku. Na morën në pyetje pse ikëm e ku kemi punuar etj. Në Strugë na mbajtën dy ditë e s'na pa njeri fare. Na çuan edhe në Shkup. Na mbajtën ca ditë e u kthyem. Policia na shoqëroi deri te kufiri. Si kaluam kufirin ndenjen nja dy ditë në kasollet e Katjelit e pastaj u nisëm për në Senisht, te shtëpia e Hakiut. Kur erdhi i ati i Hakiut na foli e mua më tha, shko se ka ardhur Astrit Çollaku e dorëzoju. Unë vajta e takova Astritin e ai më tha shko në Pogradec e do vij unë e të dorëzohesh."

Në 2 janar 1949 hetuesi merr në pyetje Hakiun. Vitin e Ri 1949 e kishin kaluar në qelitë e ftohta të burgut. Hakiu, përballë hetuesit Nuçi Tira e nis kështu rrëfimin e tij:

"Unë në 2 dhjetor u nisa për në katundin tim në Senisht për të marrë mjaltë. Kur ika në shtëpi mora leje nga magazinieri. Ikja ime ka qenë me qëllim të arratisesha për në jugosllavi se nuk shikohesha me sy të mirë nga anëtarët e partisë se ata më flisnin nga hera, duke më thënë kulak e më demaskonin vazhdimisht. Kjo ka qenë arsyeja që unë vendosa të ikja në Jugosllavi. Para se të arratisesha në Jugosllavi, jam nisur apostafat në shtëpi për të marrë armët që kisha fshehur në një kasolle, një automatik anglez, një revole austriake dhe dy bomba italiane, të cilat pasi i mora nga vendi i fshehur, i futa në çantë dhe vendosa të arratisem (mjalti ishte pretekst). Të nesërmen erdha në Kotodesh ku u takova me Aqif bej Starovën, unë i thashë Aqifit se do të arratisesha në Jugosllavi se në qeveri nuk shikohen të drejtat tona, ja edhe kongresi nuk nxori gjë se nuk nderohen më nëpunësit e mëparshëm. Në Kotodesh ndenjëm një natë e një ditë te Beqo Cenka, dhe si u ngrys u nisëm të shkonim në Jugosllavi se e dinim rrugën, që kur kam qenë partizan. Kaluam kufirin në afërsi të postës dhe dualëm në jugosllavi dhe morëm xhadenë drejt. Kur u afruam afër katundit Kalisht u kthyem te Haxhi Kalishti. Trokitëm në derë dhe ai na e hapi. Ishte ora 2 pas mesnate. Haxhiu na tha se nuk keni bërë mirë që keni ikur se ne na shikojnë me sy të keq dhe nuk jemi mirë. Në mëngjes, sa u bë ditë, na mori Haxhiu e na çoi në shtab të policisë.... Në pyetje më mori një oficer që dinte shqip e quhej Gjyro. Më pyeti ku punon sot dhe sa kohë ke që je anëtar partie. Unë i



*J pandehuri tregoi vendin e ngjarjes*

**Haki Slatina:** "Këtu në Shqipëri nuk ka liri e demokraci për popullin, se Shqipëria është një vendi vogël e i prapambetur nga pikëpamja ekonomike, politike, shkencore e kulturore, se këtu ka vetëm diktaturë për popullin se liri e demokraci ka vetëm për njerëzit që janë me pozitë e në parti e në shtet e se liri e demokraci ka në vendet e perëndimit, kapitalisto- borgjeze si në Greqi, Amerikë, Gjermani dhe në Bashkimin sovjetik e në vende të tjera, se jeta e masave punonjëse në Shqipëri është shumë e varfër, se punëtori punon për 1000 lekë në muaj dhe e paguajnë për 500 lekë, se fshatarët po vuajnë në kooperativat bujqësore e nuk marrin asgjë për të jetuar, kur në vendet kapitaliste punëtor paguhet shumë më mirë, sa kur punon 5 ditë merr të ardhura sa për një muaj për të jetuar e për të bërë qejf."

1973-1974

thashë se jam drejtor kooperative në Çërravë dhe se anëtar partie nuk kam qenë asnjëherë. Ti ke punuar për sigurimin, se ne e dimë se ke punuar, më tha. Unë i thashë se nuk kam punuar për sigurimin. Ty të ka dërguar Sigurimi këtej, tha. Unë i thashë jo se unë nga siguri- mi kam ikur. Ju pse keni ardhur këtej? Pse nuk luftoni kundër Enverit, se ai ju shtypi, ju mundon? Unë i thashë si të luftojmë kundër qeverisë, s'kemi armë, s'kemi asgjë. Gjyrua më tha, kini armë juve, s'ka shqiptar që të mos ketë armë në shtëpi! Më pyeti për Hamit Matjanin, me sa shokë është e për kë lufton ai. Unë i thashë se ka nja 5-6 shokë se ca ju vranë dhe ai vetë u plagos po se ku është nuk e di. Më pyeti për Enveri, duke më thënë se Enveri është çun, ai përjashtoi Kocin, po do të bëhet pishman. A kini bukë në Shqipëri? A shitet bereqeti lirë? Unë i thashë bukë ka dhe bereqeti shitet lirë. Po mall a keni në dyqan. Unë i thashë se kemi mall se na sjell Rusia. Sado që t'ju ndihmojë Rusia, juve jeni të rrethuar tha, dhe u ngrit e më tregoi një hartë....

Kur mbërritëm në Senisht, në shtëpi nuk e gjetëm babën se ishte në Pogradec. Të nesërmen erdhi e na tha të dorëzohe- mi. Baba i nis në Pogradec por në Prop- tisht takoi Astrit Çollakun. Unë erdha e u dorëzova me Astrit Çollakun...."

Këtu përfundon rrëfimi i parë i Hakiut. Pas një gjyqi disa ditësh, ai u dënu

me 5 vjet heqje lirie të cilin e vuajti në burgun e Korçës. U lirua në 2 janar 1954 për t'u arrestuar përsëri në 13 shtator 1954.

## 20 vjet në burgjet e Shqipërisë, Spaçi, "universiteti" i Hakiut

Pas seancash të tëra në hetuesi, Haki Slatina dënohet për herë të dytë në 4 shkurt 1955. Ai u dënua së bashku me 25 vjet heqje lirie, së bashku me Xhevit Isufin, Haki Metën dhe Veis Metën. Hakiu vuajti 20 vjet rresht në burgjet e komunizmit. Në 1974, kur po i mbaronte afati, nisin një tjetër gjyq ndaj tij. Kësaj here Hakiu akuzohej se "ka agjituar dhe propaganduar për minimin e pushtetit popullor". Në aktakuzën e prokurorit Isuf Nika, në 1975, thuhet: "I pandehuri Haki Isufi, duke qenë i dënuar për krime kundër sistemit, si armik i betuar i pushtetit popullor, edhe në kampin 303 të Spaçit, ku ka qenë duke vuajtur dënimin në vitet 1973-1974, në periudhë e kohë të ndryshme, ka bërë agjitacion e propagandë me të dënuarit për të minuar pushtetin popullor. Në këtë mënyrë Haki Isufi ka folur kundër pushtetit popullor me të dënuarit Ilia Dhima, Ylli Ahmeti, Lavdosh Liti, etj, duke thelluar më tej veprimtarinë armiqësore. Duke ju folur kundër

pushtetit personave të lartpërmendur, i pandehuri Haki Isufi ju ka thënë se "këtu në Shqipëri nuk ka liri e demokraci për popullin, se Shqipëria është një vendi vogël e i prapambetur nga pikëpamja ekonomike, politike, shkencore e kulturore, se këtu ka vetëm diktaturë për popullin se liri e demokraci ka vetëm për njerëzit që janë me pozitë e në parti e në shtet e se liri e demokraci ka në vendet e perëndimit, kapitalisto- borgjeze si në Greqi, Amerikë, Gjermani dhe në Bashkimin sovjetik e në vende të tjera, se jeta e masave punonjëse në Shqipëri është shumë e varfër, se punëtori punon për 1000 lekë në muaj dhe e paguajnë për 500 lekë, se fshatarët po vuajnë në kooperativat bujqësore e nuk marrin asgjë për të jetuar, kur në vendet kapitaliste punëtor paguhet shumë më mirë, sa kur punon 5 ditë merr të ardhura sa për një muaj për të jetuar e për të bërë qejf. Gjithashtu ai u ka folur edhe për Konferencën e Sigurimit Evropian, e me përfundimin e saj e gjithë bota do të ketë liri të plotë, se kjo do t'i shërbejë edhe popullit shqiptar e të gjithë të dënuarit do të lirohen e kufijtë e Shqipërisë do të hapen e njerëzit do të shkojnë ku të duan të jetojnë e punojnë se asaj thonë liri e demokraci të plotë për popullin, se Shqipëria në të ardhmen do të mbetet vetëm një vend bujqësor e blektoral, se mosmarrja pjesë e Shqipërisë në këtë konferencë nuk ka rëndësi se aty marrin pjesë shtete të mëdha, që nuk pyesin fare për Shqipërinë, bile as nuk e kanë në defter. Po kështu, i pandehuri Haki Isufi ka vënë në diskutim edhe marrëdhëniet e Republikës së Shqipërisë me Kinën, ku për këtë u ka thënë se Shqipëria bën një propagandë fallto e demagogjike, për të gënjyer popullin se gjoja Kina është një shtet i madh dhe i fuqishëm nga ana ekonomike, politike e shkencore, vetëm për t'i thënë botës se gjoja kemi marrëdhënie me shtete të mëdha, kur në fakt Kina nuk është ndonjë vend aq i zhvilluar se atje ka ende vise që jetojnë si në mesjetë etj.

I pandehuri Haki Isufi, duke ju folur për revoltën e të dënuarve në Spaç, që u bë vitin e kaluar, ndër mjet të tjerash iu ka thënë të dënuarve Ilia Dhima e Ylli Ahmeti, se më vjen keq që nuk u ndodha atje se po të kisha qenë atje pa tjetër do të merrja pjesë e do të udhëzoja rininë që mori pjesë në revoltë se si të vepron- te, se revolta ka bërë në një jehonë shumë të madhe në botën e jashtme, sepse atë e kanë komentuar radio e shtypi italian, se katër bombat që u hodhën në ambasadën shqiptare në Itali, kanë qenë katër heronjtë e Spaçit që ranë në revoltë dhe këtë duhet ta përkujtojmë gjithmonë.

Gjatë zhvillimeve të hetuesisë i pandehuri Haki Isufi është munduar me të gjitha mënyrat që të fshejë fajësinë e tij, por kjo u provua me dëshmitarët Ilia Dhima, Ylli Ahmeti, Fadil Kokomani, Lavdosh Lati, si dhe me ballafaqimin e bërë me dokumentet shkresore që ndodhen në dosjen penale në ngarkim të tij. Në mbështetje të hetimeve në këtë dosje rezultoi: I pandehuri Haki Isufi, i biri i Hysenit dhe i Adiles, i datëlindjes 1928, lindur e banues familjarisht në fshatin Senisht të rrethit të Pogradecit, me origjinë shoqërore fshatar i mesëm, me arsim autodiktak, i pamartuar, i dënuar dy herë për krime kundër shtetit, me kombësi e shtetësi shqiptare, akuzohet se ka kryer krimin e agjitacionit dhe propagandës kundër pushtetit popullor, që parashikohet nga neni 73/1 i Kodit Penal. (vijon në numrin e ardhshëm)

PROF. AS. DR. SKËNDER ALIU ZBULON VLERAT DHE HISTORINË E KËRKIMEVE 47-VJEÇARE PËR KUFIJTË E QYTETËRIMIT TË VJETËR

# Qytetërimi i Pelionit të lashtë, historia e të fshehtat

*Kryeqendra e shtetit të parë Ilir që prej neolitit të vonë dhe origjina e nënës së Aleksandrit të Madh*

Nga Vepror HASANI

**G**jithkush mund të ketë dëgjuar për qytetin e Pelionit. Ai ndodh diku në trevat e pellgut të Korçës, por ende nuk dihet saktësisht se ku. Tashmë ai qëndron i heshtur në pritje të zbulimit të tij. Ditën që do të gjendet nga arkeologët, ky qytet do të ketë shumë për të thënë. Nuk është çudi që të na lerë të befasuar të gjithëve. Ai është një histori e mirëfilltë e aspak trillim fantazmagorik, mendjesh të sëmura. Ai ka parë me sytë e tij, aleancat dhe luftërat mes mbretërve të vendeve fqinj, vrasjen e mbretit Perdika III të Maqedonisë, martesën e Euridikës, vajzës shqiptare, me mbretin Amynten II në Maqedoni. Prej saj do të lindte Filipi II, babai i Aleksandrit të Madh. Që nga ajo kohë lidhjet e gjakut mes dy vendeve do të shfaqeshin kohë pas kohe.

Qyteti i Pelionit është thesari i shumë dëshmiave të njohura dhe të panjohura deri më sot. Ai do t'i tregojë të gjitha. Thuhet se ai shtrihet në afërsi qytetit të Bilishtit, shumë më pranë me fshatin e Trenit, ashtu siç është thënë se Pelioni mund të gjendet në Selcën e Poshtme të rrethit të Korçës, sepse aty janë gjetur disa varre monumentale. Por përsëri nuk mund të thuhet se sa afër dhe larg tij jemi.

Kërkimet për zbulimin e këtij qyteti kanë filluar në vitin 1961, ndërsa vijojnë edhe sot e kësaj dite. Tashmë nuk është çudi që gjendemi pranë tij. Që nga çasti i zbulimit do të kemi mundësinë të njohemi me të fshehtat i fisit të Dasaretëve. E vërteta është se Pelioni ka qenë qendra e rezistencës mbretërore të shtetit të parë Ilir. Gjithsesi, se sa afër dhe sa larg Pelionit ndodhemi aktualisht, tregon arkeologu prof. as. dr. Skënder Aliu.

**- Ku shtrihet Pelioni?**

**- Prof. as. dr. Skënder Aliu:** - Sigurisht që qyteti i Pelionit gjendet në Shqipërinë juglindore. Mbi këto treva shtrihet fisi i Dasaretëve ose Dasaretia antike. Arkeologët e mirënjohur F. Prendi dhe M. Korkuti janë shprehur se Shqipëria juglindore, me qendër pellgun e Korçës përfaqëson një nga vatrat kryesore më në zë të qytetërimin prehistorik, madje jo vetëm brenda vendit dhe në rrafshin ballkanik, por edhe më gjerë se kaq. Kufijtë e shtrirjes së Dasaretisë antike ende nuk dihen me saktësi, por dihet që ajo shtrihet mbi pellgun e Korçës, mbi fushën e Devollit, mbi pllajën e Kolonjës e shkonte tutje në zonën e liqeneve të Pespës, madje deri në ujërat e liqenit të Ohrit për të vijuar më pas drejt kodrave të Grabovicës, por sigurisht shumë më gjerë se kaq... Në gjithë këtë hapësirë janë gjetur dëshmi arkeologjike. Ato flasin për një shtrirje kohore të pandërprerë duke filluar që nga neoliti i vonë në vitet 2800-2700 p. e. s., e deri në shekullin IX p. e. s.

Shqipëria juglindore kishte një pozitë gjeografike mjaft të favorshme, vijon të tregojë Aliu, dhe kjo ndikoi në zhvillimin e saj. Kishte një florë dhe



faunë të pasur, terrene të përshtatshme për bujqësi dhe blegtori, ujëra të bollshme për peshkim, ku veç këtyre kishte një pozicion kyç në kryqëzimin e rrugëve që të çonin në brigjet Adriatiko-Egjeane. Nëpërmjet luginës së Aliakmonit (lumi Bistrica) ajo lidhej me Thesalinë, ndërsa afërsia me Maqedoninë, ku zbrisin ujërat e Vardarit, e cila shërbente si rrugë drejt Danubit ka qenë tepër e rëndësishme për të. Pikërisht mbi këtë vend do të ngrihej qyteti i Pelioni, emri i të cilit do të mbetet i shkruar në burime historike mjaft të hershme, të cilat do të nënvizojnë faktin se Pelioni ishte një qytet i fuqishëm i ilirëve.

**- Cilat ishin marrëdhëniet e Pelionit me fqinjët?**



- Fuqizimi i qytetit të Pelionit nuk ishte i rastësishëm. Pozita gjeografike e Shqipërisë juglindore favorizonte lindjen e qyteteve të fuqishme. I tillë do të ishte Pelioni. Përmes rrugëve të tilla nisi tregtia. Importoheshin dhe eksportoheshin prodhime nga vende të tjera fqinje. Që nga shek XV p. e. s. nisën të vinin objekte të importuara nga punishtet dytësore mikeniane të Thesalisë. Të asaj kohe janë një enë balte e prodhimit me çarëk e tipit mikenian, e zbuluar në varrin qendror të tumës së Rehovës, 8 copë pafta floriri, nga të cilat 6 janë gjetur nëpër varret e tumës së Rehovës dhe 2 në atë të Shtikës, të cilat datojnë në shek XIII p. e. s. Si importe të drejtpërdrejta njihen gjithashtu themthoret prej floriri, enët dhe shumë fragmente qeram-

ike të prodhimit me çarëk, të zbuluara në lumin e Barçit e në vendbanimet e Sovjanit, të cilat datojnë në shek XII-X p. e. s. Me origjinë të hershme euroqendrore janë gjithashtu kategoritë e ndryshme të gjilpërave të gjata, fibulat dhe varëset gjyslykore, të cilat kanë qenë të pranishme në shumë varreza tumolare të gërmuara në Korçë dhe Kolonjë. Ato kanë hyrë fillimisht që në shek XIII p. e. s. I them të gjitha këto, sepse marrëdhënie të tilla kanë luajtur rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të Shqipërisë juglindore, por që në asnjë rast ato nuk ndryshuan karakterin etnik e pamjen e kulturës ilire. Këto marrëdhënie u intensifikuan veçanërisht në fazën e parë e të dytë të hekurit, të cilat zhvilluan më tej bujqësinë, blegtorinë, peshkimin, përsosën prodhimin e qeramikës në enët e përdorimit e të luksit, u zgjerua veprimtaria metalurgjike, u ndërtuan një varg fortifikimesh që kontrollonin rrugëkalimet, të cilat kushtëzoheshin mesa duket nga shqetësimet e dyndjeve egjeane të shek XIII-IX p. e. s. Një fakt i tillë thuhet dhe nga burimet e shkruara historike.

Por ndërsa ne njiheshim me burimet historike dhe gjetjet arkeologjike gjithnjë e më shumë mendonim për gjetjen e qytetit të Pelionit. Ai është një qytet që mund të flas shumë për këtë trevë të banuar nga dasaretët.

**- Kur erdhi fuqizimi i Pelionit?**

Në gjysmën e dytë të shekullit V p. e. s. disa nga vendbanimet e fortifikuara protourbane po shndërroheshin në qendra të rëndësishme zejtarie e tregtare me tipare qytetare, të veçuara nga bujqësia e blegtoria. (vijon në faqen 7)

# Përzjetësi në tregëti

Vjeshta e vitit 1930 vuri këmbën edhe në Slabinjë të Pogradecit. E bukur si një nuse, lozonjare, përkëdhelej kodrave, shëtiste fushave, kridheve burimeve me ujë e ftohtë. Kur shtatori po ngarkonte ditët e veta nën ca rreze dielli ledhatare, familjes Fero iu shtua edhe një djalë. Ferot u gëzuan ditët të tëra për ardhjen në jetë të pinjolit më të ri. U festua ashtu siç e kërkonte nderi i kësaj familje të madhe fisnikësh e tregëtarësh. Fëmijëria rrodhi e qetë, e bukur për djaloshin e quajtur Ferit. Moshë 12-vjeçare, si rrallë me fëmijët e tjerë, e gjeti në punë... duke mos e kthyer kokën më nga lojërat e moshës. I duhej t'i vinte shpatullat e njoma punës, për të çuar më tej vazhimesinë e tregëtisë, tregëti nisur nga gjyshi dhe të afërm të tjerë të familjes Fero. Dyqanet shtriheshin në tërë zonën e Mokrës. Fillonin nga Slabinja, shtriheshin në Ramje të Zemçës, vazhdonin në Omçanin e largët, preknin kufinj të rinj në Selcën e Sipërme. Një mbrëmje burrat tek kuvendonin odës me oxhak ku digjeshin lisat e moçëm vendosën që tregëtia të hidhte të hidhte hapat e parë edhe në qytetin e Pogradecit. Xhaxhai i babait-kurti hapi dyqanin në qytetin e bukur vendosur buzë liqenit të Ohrit. I vetëm nuk përballonte punën e re. I duhej krahu punë. Nga të gjithë nipërit ai zgjodhi Feritin, babain tonë. Një djalë i shkurtër me sy tejet të lëvizshëm, çapkën dhe i zgjuar.

Tepër i kujdesshëm dhe më kryesorja-i pa fjalë. Xhaxhai bënte furnizimin, ndërta në dyqan shërbente Feriti. Punët po shkonin më mirë nga ç'ka ishte menduar. Malli vinte prej Italisë. Vitet shkolin. Tregëtia shtohet. Puna e mirë po sillte frytet e ëndërruara... por trokiti lufta. Pa u menduar dy herë u bëmë një me të më tregonte babai. Për këtë kemi dhënë ndihma të pakursyera nëpërmjet Nuçi Tirës. Viti 1945. shqipëria u çlirua. Një vend i vogël doli i shkatërruar nga lufta. Politika e ndjekur atëherë nga shteti ynë rezultoi fatale. U mbyllën dyqanet. U ndalua tregëtia private. Kishte hrë kështu viti 1946. një perde e zezë mbuloi dritaren e familjes Fero. U mbyll papritur dritarja ku hynte drita, ajri, puna... I gjetur i vetëm, me shpirtin plagë, i dërrmuar shpirtërisht, babai u kthye në fshatin e lindjes Slabinjë, por puna e bërë në qytet la gjurmë në karakterin e djaloshit që zbriti fëmijë atëherë në qytet. U burrërua. Zanatit të tregëtisë ia njohu vlerat, por edhe të fshehtat sepse për këtë mbaroi shkollën në Pogradec. Tashmë e ndjente veten pa frikë ekonomist, bile ekonomist të fortë e të zotë.

U ngrit kooperativa edhe në anët tona. Kryetari, pa iu dridhur syri, e mori babain si ekonomist. Viti 1950 la gjurmë në jetën e djaloshit Ferit Fero. Martohet me Hanifenë, çupën e Selim Lekës, fis i ndërë për punëtorë dhe të ndershëm. Martesë që do vazhdonte për 60-vjetë

duke u bërë emblemë për 9-të fëmijët e lindur nga fryti i kësaj dashurie. Katër fëmijët e parë lindën në Slabinjë, të tjerët në qytet.

Si papandehur arriti viti 1960. u hap stabilimenti në Bishnicë. Drejtor Halit Çela i kërkoi Hamit Balliut që Feron ta transferonte në Bishnicë. Ashtu u bë. Në vitin 1961, në Bishnicë, filloi jeta e re familjare dhe shoqërore e familjes sonë, në një vend të bukur ku buronte uji i kristaltë dhe gjelbërimi i mahnitshëm. Një popullim i pakët, por ë rrjedhën e viteve do bëhej qyte e bukur plot gjelbërimi. Gumëzhinte nga zërat e punëtorëve, motorsekat.

Babai punonte llogaritar, më pas ndante edhe rrogat. Filloi një epokë e re ku babai kokë ulur, pa fjalë, gojëmbël me tërë punëtorët zinte vend gjithëandej e me shumë në zemrat e tyre. I ndërgjegjshëm dhe optimist për të ardhmenë vetë dhe të familjes. Ditët shkolin. Kaluan javë, muaj, vite. Fëmijët rriteshin. Trokitën natyrshëm edhe martesat për çiftin Fero -Hanife.

Martesat ogur i mirë u bënë në qytet...

Po vjen koha... u dukën rudhat në fytyrën e nënës sonë të dashur dhe babait por jo shpirttrave të tyre. Lindin nipëra. Familja njihet gëzime. Nëna doli e para në pensionin vitin 1979 -babaian-dej nga viti 1986. i gëzuar sepse fëmijëve u dha shkollë.

Teksa gëzonte ditët më pas vitet e para

të pensionitnë dyert e popullit tonë trokiti demokracia kaq e dëshiruar për këtë popull të vuajtur. Unë atëherë me vël-lain Nexhmiun punonim në minierën e qymyrguritvendore. Babai nuk u mendua dy herë. Më mori praën e më tha : Agim do të vish me mua. Tregëtia na pret. Dhe ashtu u bë. Një çantë të madhe e mbusha me mastika, çokollata, shkrepsë etj. nisa rrugëtimin shkollë më shkollë. Bishnicë, Velçan, Slabinjë, Proptisht e Losnik. Kjo ishte rruga për muaj të tërë. Fundi i vitit 1990 nuk po durohel më. Vendosëm të hapnim klub. Tej e vështirë sepse shteti nuk ishte rënuar por po jepte shpirtin. Nëse punon me dashuri dhe përkushtim çdo punë të shpërblen. Kështu ndodhi edhe me ne, me klubin që hapëm pa harruar të hidhnim shikimin nga qyteti, kohë kur babai kishte punuar fëmi. Ndërtuam shtëpi. Gjetëm treg. Guxuam në një fushe të re dhe të pa njohur më parë. Tregëtimin e luleve natyrale. U lidhëm me Hollandën -vendin e luleve. Shtrirja e tregëtisë pati jehonë tek nipi Rolandi-djali i Shemes. Hapi furrë buke në Greqi. Vajza e dashur Valbona çeli dyqan shumice në Përrenjas. Shikoja babain. I ndriste fytyra. I qeshte shpirti. Tregëtia po merrte rrugën e dëshiruar nga ai vetë.

Viti 2007. nëna jonë mbylli sytë. Kjo ishte goditja e parë e fortë për babain. Një tjetër akoma më e rëndë priste te dera. I vdes e bija nga një sëmundje e rëndë. Tashmë hapin e ka të rënduar nga vitet, por na shikonte sa herë tekta punonim. Merrte pastaj pusionin e rigazetën e humbiste nëpër lexime.

Ndërroi jetë nga një sëmundje e rëndë. Shkoi pranë njerëzve që i deshi kaq shumë përgjatë gjithë jetës-gruas dhe së bijës.

Agim Fero

## Qytetërimi i Pelionit të lashtë, historia e të fshehtat

(vijon nga faqja 6)

Pikërisht në këtë kohë edhe qyteti i Pelioni mori përmasat e një qyteti të rëndësishëm. Arianiti dhe Kurt Rufi pohojnë se, 'Pelioni u bë qendra e rezistencës mbretërore e shtetit Ilir'. Materiallet arkeologjike të gjetura në kalanë e Symizës të Korçës, në Hollm të Kolonjës, në Trebenishtë pranë Ohrit, tregojnë se kultura ilire e rajoneve të Shqipërisë juglindore në shekujt VI-V p. e. s., kishin të njëjtin nivel zhvillimi me atë të krahinave fqinje ilire të Maqedonisë. Megjithatë, meqenëse importi nga Greqia paraqiste vështirësi për shkak të distancave shumë të largëta, bëri të mundur të përshejtohej procesi i zejtarizimit të qeramikes për të plotësuar kërkesat e konsumatorit vendas. Kategoria e qeramikes me çark në gjysmën e dytë të shekullit VI p. e. s., riprodhon forma të traditës ose forma të importuara ojnohe, skifos, kantarëgutus, kupa etj. Vlerë të njëjtë nisin të marrin edhe zbukurimet trupore prej bronzit të njëkohshme dhe tipologjikisht të ngjashme me ato të Maqedonisë perëndimore. Krahas armeve, heshtat dhe shtizat prej hekuri, shpatat e tipit mahera, anxharët, kamat, përkrenaret, por edhe disa objekte simbolike, si skeptrat (shkopi i sundimitarit) paraqesin karakterin oplit në përshtatje me kohën. Por që të gjitha këto nuk flasin për armët e vetëmbrojtjes, por për një kompletim të sistemit të armatimit në funksion të aristokracisë ushtarake. Fakte të tilla tregojnë se qyteti i Pelionit po fuqizohej edhe ushtarakisht.

- **A është Pelioni qyteti i rezistencës?**

- Qyteti i Pelionit mund të jetë bërë i famshëm për rezistencën e tij në fund të shekullit V p. e. s. E them këtë, sepse nëse i referohemi Tukuditit, i cili është



një burim i besueshëm historik, ai na tregon për ilirët, të cilët në përkrahje të Lynkestëve, nisën luftën me Maqedoninë. Sipas burimeve historike, kjo ka ndodhur në vitin 423 p. e. s. Ka të ngjarë që në krye të shteti të parë Ilir, mbret të ketë qenë Sira, i cili kishte patur konflikte të vazhdueshme me maqedonasit. Megjithatë, ai për të lidhur marrëdhëniet të mira me Maqedoninë shfrytëzoi modelet e asaj kohe. Nuk bëri gjë tjetër, veçse vajzën e tij, Euridikën e martoi me Amynten II, i cili në atë kohë ishte mbret i maqedonasve. Nga kjo martesë do të lindte Filipi II, ose baba i Aleksandrit të Madh. Në fillim të shekullit të IV p. e. s., kur mbret do të ishte Bardhyli, ky shtet do të njihet fuqizimin më të madh ekonomik dhe ushtarak. Pikërisht në

këtë periudhë shteti Ilir u përfshi sërish në konflikte me Maqedoninë. Megjithatë, në vitin 393 p. e. s., doli fitues ndaj saj duke detyruar maqedonasit t'i paguanin një haraç vjetor. Maqedonasit u thyen përsëri në vitin 369 p. e. s., por edhe në vitin 360 p. e. s., ku prej tyre mbetën 4000 të vrarë, madje edhe mbreti Perdika III. Më pas përplasjet do të shënoheshin mes mbretit Bardhyli të ilirëve dhe mbretit Filipi II i maqedonasve, i cili në të njëjtën kohë ishte dhe djali i Euridikës nga Shqipëria. Bardhyli u mposht në vitin 359 p. e. s., por Filipi II asnjëherë nuk deshi të nënshtronte Ilirët. Ai dinte që nëna e tij kishte qenë nga Disaretia, ose nga Shqipëria juglindore. Në vitin 344 p. e. s., Filipi kishte zgjeruar kufijtë e tij drejt Trak-

isë, ndërsa kishte nënshtruar ushtarakisht gjithë Greqinë. Megjithatë, gjatë kësaj periudhe qyteti i Pelionit do të mbetej qendra e rezistencës së shtetit të parë Ilir. Ky fakt ka tërhequr vëmendjen e shumë studiuesve.

- **Sa afër dhe larg Pelionit jemi?**

- N. Hamond mendon se Pelionin mund ta kërkojmë te 'Goricat e Trenit', por tashmë kjo tezë nuk mbështet më nga ana arkeologjike. Neritan Ceka sjell argumentin se Pelioni duhet kërkuar te Selca e Poshtme, sepse aty janë gjetur disa varre monumentale. Ky argument duket bindës dhe i qëndrueshëm. Sh. Gjonkecaj, mbas studimit të thesarit që u gjet rastësisht brenda mureve të kalasë 'Hija e Korbit', në fshatin Klocë, pretendon se Pelioni mund të gjendet aty. Edhe kështu mund të jetë. Ato që do të zbulojnë Pelionin e famshëm të pellgut të Korçës, kryeqendrën e shtetit të parë Ilir do të jenë gërmimet arkeologjike. Gërmimet sollën zbulimin e Dimalit në Berat dhe të Antigonës në Gjirokastrë. Gjetjet epigrafike do të flasin për gjithçka. Gjithsesi unë mendoj se tashmë ka ardhur koha të lokalizohen kështjellat e qytetit, emrat e të cilave i njohim nga burimet historike. Këto burime përmendin kështjella të tilla si, 'Bantia i Kaloikenëve', 'Orgesa i Pisantinëve', 'Enkelana Bojoja', 'Lynidit', 'Keraka', 'Satinioni', 'Kreoni', 'Geruni', 'Kadrioni', 'Kreoni' etj. Lokalizimi i kështjellave apo qyteteve, por veçanërisht lokalizimi i Pelionit, si kryeqendra e shtetit Ilir do të hidhte dritë mbi ngjarjet historike dhe politike që kanë të bëjnë me Dasaretinë. Gjithsesi gërmimet e filluara nga viti 1961 e deri më sot do të na çojnë drejt këtij qyteti të njohur me emrin Pelion.

Vepror Hasani

# Nënprefektura e Librazhdit

## BASHKIA LIBRAZHD

*Përfshihet në Qarkun e Elbasanit.*

**Përfshin:** Qytetin Librazhd, ka 1 Bashki, në Përrenjas dhe 9 Komuna, Qendër, Qukës, Stravaj, Rrajcë, Hotolisht, Polis, Lunik, Stëbleve, dhe Orenjë.

**Numri i popullsisë:** 9.834 banorë

**Sipërfaqja:** 13 km<sup>2</sup>

**Vendndodhja:** Në Shqipërisë e mesme  
**Dega Kryesore e ekonomisë:** Industri druri, tregëtia, bujqësi

**Biznese:** 360

Bashkia Librazhd shtrihet në pjesën lindore të Shqipërisë mesme, në Krahinën Malore Qendrore, në luginën e mesme të Shkumbinit, pranë bashkimit me lumen Rrapun. Është një vendbanim i lashtë dikur një stacion në rrugën Egnatia dhe njihet me emrin Libaros.

U shpall qytet në vitin 1958, duke u ndërruar nga qarku i Elbasanit. Ka qenë e zhvilluar kryesisht industria ushqimore. E njohur ka qenë vera e Librazhdit. Sot ka një popullsi prej 9.834 banorë dhe shtrihet në një sipërfaqe prej 13 kilometra katrorë. Aty veprojnë 360 biznese, nga të cilët 181 janë në fushën e tregtisë, 9 më karakter prodhues, 36 në fushën e shërbimeve, 96 në fushën e transportit. Ka 2 kopshte fëmijësh 2 shkolla fillore, 2 shkolla 9-vjeçare, 1 shkollë të mesme, Në qytetin e Librazhdit për çdo vit zhvillohet Festivali i Valles Dyshe, një veprimtari e veçantë në gjininë e kërcimit popullore.

## BASHKIA PËRRENJAS

*Përfshihet në Qarkun e Elbasanit.*

**Përfshin:** Qyteti Përrenjas dhe fshatrat Përrenjas-Fshat, Rashtan.

**Numri i popullsisë:** 8.085 banorë

**Sipërfaqja:** 12 km<sup>2</sup>

**Vendndodhja:** Në pjesën qendrore të Shqipërisë.

**Dega Kryesore ekonomisë:** Industri miniera, druri, bujqësi

**Biznese:** 16

Bashkia Përrenjas shtrihet në verilindje të fushës Domosdovës. Përmen-det në historinë e Mesjetës për një nga betejat më të ashpra të zhvilluara nga Skënderbeu kundër pushtuesve osmanë zhvilluar më 1445, në fushën e Mokrës. Përrenjasi në vitin 1957, pasi u hap miniera e parë e Pishkashit, u bë qendër e sektorit të kësaj miniere. Në vitin 1958 ka filluar ndërtimi i qytetit të punëtorëve, duke marrë emrin e fshatit Përrenjas, i cili ndodhesh aty afër. Ndër degët kryesore të ekonomisë në Përrenjas ka qenë ajo nxjerrjes dhe përpunimit të hekur-nikelit. Ky aktivitet ka vazhduar deri në vitet 1989-1990 duke u shtrirë në shumë sektorë të kësaj miniere deri në Pojskë, Katjel, Rrodokal, Homezh, Skroskë, në thellësitë e tuneleve të Bushtricës dhe deri ato kërkim zbulimet e gjeologjisë në majën e Shebenikut dhe shumë pika të tjera. Ishte parku i transportimit të mineralit dhe lendes drusore një park shumë i fuqishëm.

Ka një popullsi prej 8.084 banorë dhe shtrihet në një sipërfaqe prej 12 kilometra katrorë. Aty veprojnë mbi 16 biznese në fushën e tregtisë, në fushën e shërbimeve, në fushën e transportit e tjera., Ka 2 kopshte fëmijësh shkolla fillore, shkolla 9-vjeçare, 1 shkollë të mesme.

## KOMUNA RRAJCË

**Komuna Rrajcë përfshin 7 fshatra:**

**Rrajcë, Sutaj, Skënderbej, Bardhaj, Katjel, Kotodesh, dhe Uarakë.**

**Numri i popullsisë:** 10.594 banorë

**Sipërfaqja:** 8.3 km katrorë



**Vendndodhja:** Në Shqipërinë e mesme

**Dega Kryesore e ekonomisë:**

**Bujqësi, prodhim drithërash**

**Biznese:** 38

Komuna Rrajcë ndodhet verilindje të fushës Domosdovës. Në qendër të fshatit ndodhet një vendbanim i periudhës së neolitit të hershëm, në lagjet që mbajnë emrin Kostričan, e Skënderbej janë rrënojat e një qyteze ilire të shekullit VIII-të p.e, janë shenjat e degëzimit të rrugës Egnatia, shkalla e Skënderbeut në një mjedis guri e hapur me mjete të kohës së luftës të asaj kohe e cila shërbeu si një element kryesor për arritjen e fitores së ushtrisë së Skënderbeut ndaj forcave të shumta të ushtrisë osmane.

Në fillimet e Luftës Ballkanike, Rrajca është djegur e shkatërruar mbi tre herë nga ushtria serbe. Në trevën e Rrajcës është i njohur grupi karakteristik i valleve të Rrajcës i cili ka arritur të marrë vlerësime maksimale dhe çmime të mëdha në arenën kombëtare dhe ndërkombëtare.

Sot komuna e Rrajcës ka 10.594 banorë, përbledh 7 fshatra dhe shtrihet në një sipërfaqe prej 8.3 kilometra katrorë. Aty veprojnë 38 biznese, me aktivitete të ndryshme. Ka 6 kopshte fëmijësh, shkolla fillore, 7 shkolla 9 vjeçare dhe 3 shkollë të mesme.

## KOMUNA QUKËS

**Komuna Qukës përfshin 11 fshatra:**

**Qukës Shkumbin, Qukës Skënderbej, Skroskë, Mënik, Gurrë, Bërzesh, Fanjë, Kkarkavec, Dritaj, Pishkash, dhe Pishkash Veri.**

**Numri i popullsisë:** 10.841 banorë

**Sipërfaqja:** 110.3 km katrorë

**Vendndodhja:** Në Shqipërinë e Mesme

**Dega Kryesore e ekonomisë:**

**Bujqësi, frutikulturë**

**Biznese:** 37

Komuna Qukës ndodhet në juglindje të Librazhdit. Në afërsi të Qukës ka qenë një stacion i rrugës "Egnatia" me emrin "Tres Tabernas". Në jugperëndim ndodhen muret e një qyteze ilire, tashmë një monument kulture.

Sot komuna Qukës ka një popullsi prej 10.841 banorësh, përbledh 11 fshatra që shtrihen në një sipërfaqe prej 1103 kilometra katrorë. Drejtimi kryesor i ekonomisë ka qenë kryesisht bujqësia, dhe prodhimi frutave. Aty sot numërohen 37 biznese, në fusha të ndryshme të shërbimeve, transportit, e ambulatorë. Ka 12 kopshte fëmijësh, shkolla fillore 7 shkolla 9 vjeçare dhe 2 shkollë të mesme.

## KOMUNA HOTOLISHT

**Komuna Hotolisht përfshin 7 fshatra:**

**Hotolisht, Dardhë, Vulçan, Buzgarë, Kokrevë, Vehçan, dhe Xhyrë.**

**Numri i popullsisë:** 7.010 banorë

**Sipërfaqja:** 152.5 km katrorë

**Vendndodhja:** Në Shqipërinë e Mesme.

**Dega Kryesore e ekonomisë:**

**Bujqësi, dhe perime.**

**Biznese:** 49

Komuna Hotolisht ndodhet në të djathtë të lumit Shkumbin, në juglindje të Librazhdit. Përmendet si një vendbanim që në shekullin XV.

Komuna Hotolisht ka një popullsi prej 7.010 banorësh, përbledh 7 fshatra, dhe shtrihet në një sipërfaqe prej 152.5 kilometra katrorë. Drejtimi kryesor i ekonomisë ka qenë kryesisht prodhimi bujqësor e blegtoral. Aty sot veprojnë 49 biznese, të cilët janë në fusha të ndryshme të tregtisë. Ka 8 kopshte fëmijësh, shkolla fillore 7 shkolla 9 vjeçare dhe 1 shkollë të mesme.

## KOMUNA STRAVAJ

**Komuna Stravaj përfshin 6 fshatra:**

**Stravaj, Stranik, Farret, Shqiponjë, Gaferr, Sopot.**

**Numri i popullsisë:** 3.672 banorë

**Sipërfaqja:** 102.6 km katrorë

**Vendndodhja:** Në Shqipërinë e Mesme

**Dega Kryesore e ekonomisë:** Bujqësi, industri Druri, frutikulturë

**Biznese:** 15

Komuna Stravaj ndodhet në jug të Librazhdit. Është një vendbanim i ri, me banorë të ardhur nga fshati Slatinë i Rrethit Pogradec. Nga ana etnografike bën pjesë në zonën e Mokrës. Nga viti 1956 ka filluar shfrytëzimi i pyjeve të cilat kanë qenë shumë të pasura të Stravajt.

Sot komuna Stravaj ka një popullsi prej 3.672 banorësh, përbledh 6 fshatra, dhe shtrihet në një sipërfaqe prej 102.6 kilometra katrorë. Drejtimi kryesor i ekonomisë ka qenë kryesisht prodhimi bujqësor, dhe pjesërisht frutikultura e blegtoria. Aty sot veprojnë 15 biznese, të cilët janë me karakter të ndryshëm në fushën e tregtisë. Ka 2 kopshte fëmijësh, shkolla fillore dhe 5 shkolla 9 vjeçare.

## KOMUNA QENDËR

**Komuna Qendër përfshin 12 fshatra:**

**Librazhd Qendër, Arrëz, Babje, Dorëz, Dragostunjë, Kuturman, Gizavesh, Librazhd Katund, Marinaj, Qarrishtë, Spathar, e Togëz.**

**Numri i popullsisë:** 11.823 banorë

**Sipërfaqja:** 203.1 km katrorë

**Vendndodhja:** Në hqipërinë e Mesme

**Dega Kryesore ekonomisë:**

**Bujqësi, industri druri, frutikulturë**

**Biznese:** 47

Komuna Qendër ndodhet në lindje të Librazhdit dhe përmendet si fshat nga viti 1467. Në veri, në malin e Sahkës, është zhvilluar një përpjekje e Skënderbeut me Osmanët. Këtu ka qenë një sharrë e cila punonte me ujë dhe përdorej për përpunimin e lëndës drusore.

Ka pasur drejtim kryesor prodhimin e drithërave të bukës përpunimin e lëndës drurit dhe rritjen e bagëtive.

Sot komuna Qendër ka një popullsi prej 11.823 banorësh, përbledh 12 fshatra, dhe shtrihet në një sipërfaqe prej 203.1 kilometra katrorë. Aty sot veprojnë 47 biznese, të cilët janë në fusha të ndryshme të tregtisë transportit e tjera. Ka 10 kopshte fëmijësh, shkolla fillore, 9 shkolla 9 vjeçare, dhe 1 shkollë të mesme.

## KOMUNA POLIS

**Komuna Polis përfshin 6 fshatra:**

**Polis, Mirakë, Gostimë, Sheh, Gurëshpatë, Vilan.**

**Numri i popullsisë:** 5.000 banorë

**Sipërfaqja:** 98.7 km katrorë

**Vendndodhja:** Në Shqipërinë e Mesme.

**Dega Kryesore e ekonomisë:**

**Bujqësi, e blegtori**

**Biznese:** 36

Komuna Polis, ndodhet në krahun e majtë të rrjedhjes së Shkumbinit, në jugperëndim të Librazhdit. Është vendbanim i hershëm. Në lindje të Polisit ndodhen mbeturinat e një qyteze ruhen gojëdhëna mbi luftërat e Gjergj Aranitit në shekullin e XV-të kundër pushtuesve osmanë. Është i përmendur për mjeshtërinë e përpunimit të bulmetit. Sot komuna Polis ka një popullsi prej 5.000 banorësh, përbledh 6 fshatra, dhe shtrihet në një sipërfaqe prej 98.7 kilometra katrorë. Aty sot veprojnë 36 biznese, në fusha të ndryshme, sipas interesave të komunitetit. Ka 8 kopshte fëmijësh, 10 shkolla fillore 6 shkolla 9-vjeçare dhe 1 shkollë të mesme.

## KOMUNA LUNIK.

**Komuna Lunik përfshin 7 fshatra:**

**Lunik, Preval, Dranovicë, Kostenjë, Letëm, Zgosht, Koshorisht**

**Numri i popullsisë:** 5.554 banorë

**Sipërfaqja:** 108.8 km katrorë

**Vendndodhja:** Në Shqipërinë e Mesme

**Dega Kryesore e ekonomisë**

**Bujqësi, dhe blegtori**

Komuna Lunik ndodhet në veri të Librazhdit, përgjatë rrugës Librazhd Peshkopi. Përmendet që në kohët e lashtë që nga viti 1467 me emrin "Lubnik" Në lagjen Gradec të tij ndodhen rrënojat e një qyteze. Sot komuna Lunik ka një popullsi prej 6.460 banorësh, përbledh 6 fshatra, dhe shtrihet në një sipërfaqe prej 64.7 kilometra katrorë. Aty sot veprojnë 82 biznese, nga të cilët 18 janë në fushën e tregtisë, 3 janë me karakter prodhues, 7 në fushën e shërbimeve, 42 të licensuara për veprimtari të ndryshme, 9 në fushën e transportit, 3 ambulatorë. Ka 6 kopshte fëmijësh, 6 shkolla fillore, 6 shkolla 9 vjeçare, dhe 1 shkollë të mesme.

## KOMUNA STËBLEVË

**Komuna Stebleve përfshin 7 fshatra:**

**Sterblevë, Zabzun, Borovë, Llangë, Moglicë, Prodan**

**Numri i popullsisë:** 1.660 banorë

**Sipërfaqja:** 119.5 km katrorë

# Këngët

Nga HYSEN FILJA \*

Ekspedita dy javore në krahinën e Mokrës kishte për qëllim të kryente një eksplorim të gjerë dhe të thellë në një pjesë të fshatrave të Mokrës, në Mokrën e Sipërme dhe në Mokrën e Poshtme, si edhe në zona të thella malore.

Interes të veçantë paraqiti puna në Mokrën e Sipërme, veçanërisht në fshatrat Rrodokal dhe Podgozhan.

Në repertorin e grave, përta i përket folklorit tradicional, vendin kryesor e zinin këngët e ceremonialit të dasmës, ndërsa në atë të burrave e zinin këngët historike, megjithëse këto të fundit janë më të pakta se sa në disa krahina të tjera të vendit.

Të kënduarit në grup përbën një nga veçoritë më kryesore të këtyre fshatrave, ku njëri ia merr, një tjetër ja thotë, ndërsa të tjerët mbajnë "zë". Siç dihet, kjo mënyrë të kënduarit me tre zëra, është karakteristikë për të gjithë zonën e toskërisë. Ajo dallohet për melodinë e pasur, veçanërisht të atij që ja merr, e cila është e mbushur me zbulime të ndryshme, ndërsa, përta i takon ritmit, shpesh herë ai është i lirë.

Ndryshe nga burrat, gratë, vërtetë këndojnë në grup, por interpretimi i tyre në disa fshatra është në diafoni, megjithëse, shpesh here, zëri i dytë shpëputet në momente të caktuara, duke të krijuar përshtypjen e një grupi polifonik me tre zëra, por në këtë rast, ata që mbajnë "zë", nuk theksojnë "e" por shqiptojnë fjalët e vargjeve njëllor me të tjerët.

Kjo mënyrë të kënduarit (diafoni) për disa nga karakteristikat e saja të veçanta, paraqet interes për studim. Ajo qëndron si një formë ndërmjet homofonisë dhe polifonisë, ndoshta është faza e parë e polifonisë prej nga ku, më vonë, shpëputen zërat e tjerë, duke krijuar kështu më qartë profilin e tyre të veçantë.

Meloditë e këngëve që këndohen në këto fshatra janë më të varfëra se sa vargjet që trajtojnë këto këngë. Kjo vjen për faktin se me një melodi mund të këndohen disa tekste që shprehin përbajtje të ndryshme, por të një gjinie, megjithëse, dhe në këtë rast, ekzistojnë dallime të veçanta ndërmjet këtyre këngëve, nuanca, ndoshta, të parëndësishme, por që luajnë rol në tingëllimin e përgjithshëm të këngës.

Interes të veçantë paraqiste sidomos dhe grupi i grave të fshatit Podgozhan, grup solid, mjaft i përgatitur dhe me një repertor të pasur. Në grup bënë pjesë



gra të moshave të ndryshme, duke filluar nga 20 deri 70 vjeç. Ky grup që përbëhej nga 20 gra, incizoi mjaft këngë, ndërmjet të cilave vendin kryesor e zinin këngët e dasmës, Ky grup, përveç materialeve të tjera, incizoi një këngë për mbledhjen e bletës dhe një vaj, i cili, për mënyrën e të kënduarit, paraqet interes të madh për studim.

Gratë e këtij fshati këndojnë në diafoni me po ato karakteristika që këndojnë dhe gratë e fshatit Rrodokal. Por është interesant fakti se gratë e fshatit Podgozhan e Povelan, ndryshe nga burrat, që kanë një të kënduar të përbashkët, atë të të gjithë zonës, këndojnë në diafoni, ndërsa gratë e fshatrave fqinjë, Dunicë, Trebinjë. Çezmë e Madhe, Çezmë e Vogël etj., këndojnë vetëm në polifoni. Ky është një fenomen tjetër që meriton vëmendje të veçantë, se ka të bëjë, sidomos, me prejardhjen e polifonisë tonë popullore.

Dihet se edhe vajet përbëjnë një pasuri të madhe të krijimtarisë popullore. Ato na çojnë deri në periudhat më të lashta të shoqërisë njerëzore. Në vajin e incizuar, gratë e Podgozhanit vajtuat partizanet dëshmore të fshatit të tyre. Mënyra e të vajtuarit, me këtë rast, ishte e njëjta me këngët e tjera që këndojnë këto grupe, me ndryshimin se ritmi, në disa nuanca të tjera që lindin nga emocionet e thella dhe që krijohen në këto raste, ndryshojnë nga ato të këngëve të

tjera.

Ekspedita incizoi dhe mjaft këngë të tjera në 12 fshatra, si këngë dashurie, këngë kurbeti këngë djepi etj, etj, si dhe një numër të madh vallesh popullore që u filmuan nga specialistët.

Ja disa nga konkluzionet e nxjerra nga ekspedita: Në përgjithësi zona e Mokrës (veçanërisht Mokra e Sipërme) është një zonë e pasur, ku ruhet ende një trashëgimi e pasur folklorike. Sigurisht, gjallë ndryshimeve të mëdha që janë bërë gjatë këtyre viteve të çlirimit, kjo trashëgimi nuk jeton në atë masë që jetonte më parë. Arsyet janë të njohura.

Nga afrimi gjithnjë e më i madh i fshatit me qytetin, nga depërtimi i radios dhe këto kohë e fundin i televizionit në fshat, nga ngritja e nivelit kulturor dhe përvetësimi i një jetese gjithnjë e më të kulturuar, duhet thënë se, disa nga gjinitë e folklorit, po zhduken. Të tilla janë këngët e djepit. Nën fshatare, ashtu si dhe ajo qytetare, nuk i këndon më fëmijë si më parë. Ajo tani është një ndërtesë e denjë e shoqërisë, kështu që jeta e saj është e pandarë me atë të kolektivit. Fëmijët tani rriten pronë çerdheve që janë ngritur në çdo fshat. Pikërisht kjo është dhe arsyeja kryesore që këto këngë nuk po ndihen më. Prandaj, ato që incizuan këngë djepi ishin vetëm nëna të moshave të thyera, ndërsa nënat e reja, në shumicën dërmuese, nuk dinin këngë të tilla.

Edhe këngë për punën, siç janë këngët për mbjelljen e të lashtave, për mjelljen e lopëve, për mbledhjen e bletëve etj., këngë që hedhin dritë mbi një kulturë të lashtë të popullit tonë, megjithëse shumë të rralla, këto kohë e fundit pothuajse nuk dëgjohen.

Këngët folklorike tradicionale që rrojnë akoma në gojën e popullit dhe që mund t'i takosh në moshë të ndryshme janë, për gratë, këngët e dasmës dhe të dashurisë. Këngët ceremoniale të dasmës, megjithëse shumica e tyre sot nuk këndohen, mund t'i gjesh jo vetëm në krahinën e Mokrës, por dhe në shumë fshatra të tjerë të Shqipërisë. Pikërisht për këtë, këto këngë zënë dhe vendin më të madh në incizimet e bëra gjatë kërkimeve në këtë rreth.

Repertori i burrave, ndryshe nga i grave, nuk ishte i pasur. Interesante është se këngët historike të mokrareve ishin shumë të pakta. Megjithatë u bënë disa incizime këngësh të tilla.

Nga instrumentet më karakteristike që përdoren në krahinën e Mokrës janë gajda dhe fyelli. Nga repertori i tyre u incizuan valle me gajde dhe melodi me gajde, ndërsa me fyell melodi baritore.

Ekspedita, siç shihet, shfrytëzoi më tepër folklorin tradicional; meqenëse dhe puna për grumbullimin e tij paraqitet më urgjente, por kjo nuk do të thotë se nga folklori i ri nuk u bënë incizime. Janë krijuar këngë të cilat përbëjnë një pasuri të madhe të krijimtarisë së popullit dhe që, për frymën e tyre, optimizmin dhe dashurinë për atdheun dhe partinë, ruajnë vlera të mëdha.

Duke parë krijimtarinë popullore të këtyre viteve të fundit, mund të themi se fenomenet më të rëndësishme që vihen re janë dy, e para, se këngët që rrojnë më tepër nga folklori tradicional janë këngët historike, të cilat dhe sot këndohen dhe gëzojnë popullaritet, ndërsa këngët lirike, vërtet rrojnë në popull, por përdorimi i tyre është shumë i kufizuar. Nga ana tjetër po lindin këngë të gjinive të ndryshme, dhe pasurohen gjinitë ekzistuese me krijime të reja, që këndohen në festa të ndryshme popullore.

Ekspedita e Mokrës, ashtu si gjithë ekspeditat e tjera të organizuara herë pas here nga Instituti i Folklorit tregoi se folklori, qoftë ky muzikor apo ko-reografik, rron në popull dhe pasurohet nga dita në ditë me krijime të reja.

"Gazeta "Drita", 21 janar 1973

## NUK ARRESTOHET POETI KOMBËTAR LASGUSH PORADECI!

Në verën e vitit 1962 kalova pushimet në Pogradec dhe atje pata rast të takohem dhe të qëndroja gati për ditë në shoqëri me Lasgushin. E takoja zakonisht në turizmin e vjetër nën hijen e plepave, ndonjëherë në shtëpi, po nga bisedat e tij më kanë mbetur në kujtesë ato të kopshti me mollë të familjes Çollakëve. Nën degët e rënduara të mollëve rrinin e bisedonim me orë të tëra, po më shumë dëgjonim Lasgushin. Isha unë, Mark Gurakuqi, Gjergj Vlasi, Misto Marko, dhe Qaniu, i zoti i shtëpisë, vëllai i Reshit Çollakut. Me Çollakët, Lasgushin e lidhte një miqësi e vjetër familjare. Ai i cilësonte ata fis trimash, po jo më pak quante të tillë edhe Gushot. Të dy fiset qenë daluar për atdhedashurinë e tyre që nga Rilindja. Në kohën e Luftës Nacionalçlirimtare Reshiti dhe kushëriri i poetit, Koli Gusho, kishin rënë së bashku heroikisht në betejën e Pojskës. Lasgushi ndihej më tepër se krenar për këtë. Kjo duket dhe në dy elegjitë e bukura kushtuar vëllezërve dëshmore, Reshit dhe Muharrem Çollaku. Këto janë të vetmet krijime


me motive bshkëkohore, që bënë të zgjohet mua e poetit në vitet pas çlirimit. Mbaj mend se i kish për zemër dhe e kam dëgjuar disa herë duke i recituar me atë mënyrën e tij karakteristike, duke tundur njërin dorë e me zë të lartë. Përse nuk shkroi vjersha të tjera Lasgushi me tema të kohës, veç këtyre dy elegjive dhe disa vagëzime të rëndomta.

Tregimet e tij për luftën i kam dëgjuar për herë të parë në Pogradec. Më pas në Tiranë m'i ka përsëritur të njëjtat episode, duke i dhënë ngjyrim e nuance, që dinte t'u jepte vetëm ai.

Njëherë mbaj mend të më rrefente: -Në kohën e Luftës Lasgushi s'mund të luftonte. Ai s'ishte partizan. Partizanët luftonin, Lasgushi ishte poet. Një njeri si unë vetëm mund të ndihmonte. Jo se kasha frikë. Frikën s'e kam as fis, as në karakter. Por për të ndihmuar, ndihmoja. Jepja para, bie fjala, aq sa mundja, po jo aq sa ma donte zemra. Shkoja në rrugën e "Kusit", në shtëpinë e Trajan Pekmezit, dëshmor nga Pogradeci, dhe jepja kontributin tim për partizanët. Po Lasgushi nuk jepete vetëm para. E ke

dëgjuar emrin e Sabaudin Gabradit? Me të isha i lidhur unë. Kur iku për herë të fundit në Tiranë me një veturë të mbushur me bomba, dhe e kapën fashistët, u nis nga shtëpia ime. Ç'nuk i bënë para se ta vrisnin, torturat nga më të dhemburat që të tregonte po ai nuk nxori asnjë fjalë për Lasgushin. Dhe Lasgushi, edhe pas kësaj s'u zmbrops. Përkundrazi, hyri në punë më të rrezikshme. Shkonte në pazarin e vjetër, te dyqani i Pekmezëve. Atje sillte armë nga Poradeci Tahiri, një mekanik trim, dhe unë i merrnija të mbështjella me rrogë. E pësoi pastaj i shkreti Trajan. E vranë mercenarët e Xhelal Staraveckës. Lasgushin nuk e ngiste njeri. Ata s'e dinin që unë nuk i doja fashistët. Një herë tjetër, pasi strehova ilegalë në shtëpi, shoqërova në makinë, me dokumenta të fasilfikuar një të Nacionalçlirimtares deri në Pogradec.

Lasgushi nuk mund të bënte ndryshe nga ç'bante populli. Populli s'i trembej rrezikut. Dhe Lasgushi s' trembej. Nuk iu tremba as Hilmi Lekës, një gazetari fashist, që drejtonte gazetën "Tomorri", ku unë botova historinë e kolonisë sh-



qiptare të Bukureshtit. Ai më ndërroi frazën "luftonin okupatorin turk" me fjalët "luftoni për Shqipëri". I vajta në zyrë i zemëruar dhe e kapa pas spaletave (se ai rrinte i veshur me uniforme fashiste. Ai nxori revolen e desh të më kërcënojë, po ndërhyne dhe e ndanë.

(vijon ne faqen 12)

# Krisje e shpirtit të hepuar në mote

**K**a lindur aty ku zë fill legjenda e Kadmit dhe Harmonisë, zoterit e Liqenit të Ohrit dhe fisit të lashtë të Enkelejve, aty ku edhe u lindën dy korifentë e letërsisë shqipe Lasgush Poradeci dhe Mitrush Kuteli. Pasionant dhe dashamirës "kryeneç" i letërsisë, i ëndërrës për të shkruar, rritur mes rrëfimit dhe imazheve të përrallave mahnitëse në trevën e tij që e ngazëllyen të gjejë një mënyrë të vetën për të komunikuar me të shkuarën dhe të tashmen, me legjendat si mendimtare mbresëlënëse të kohës e realitetit, ekuacione të ngjizura me opusin konceptual letrar e njerëzor. Prozatori-fizikant Istref Haxhillari ka një rezymë të pasur të krijimtarisë së tij letrare në zhanrin e romanit eseve dhe tregimit, në shqip e anglisht, autor bashkëkohor i vlerësuar nga kritika letrare, nga lexuesit e shumtë dhe i vlerësuar me cmime. Kush është shkrimtari pogradecar Istref Haxhillari, krijimtaria e tij letrare, si u bë shkrimtar Profesori i Fizikës dhe e ardhmja e krijimtarisë së tij, do t'i mësojmë në këtë bisedë interesante, plot vitalitet që unë pata nderin të zhvilloja me të.

**1- Kush është Istref Haxhillari? Për çfarë keni studiuar?**

**I. Haxhillari:** - Jam lindur në Pogradec ku mbarova arsimin e mesëm. U diplomova për Fizikë në Universitetin e Tiranës. Më pas kam kryer kursin pasuniversitar për këtë specialitet. Ëndërra im e hershme ka qene letërsia. Në kërkesën për studime në Universitet ku duheshin shënuar tri degë alternative shkrova tri herë fjalën magjike "letërsi". Në kundërshtim me dëshirën time me çuan për fizikë. Më tej mësuës dhe drejtor shkolle, pastaj inspektor, shef i arsimit të rrethit Pogradec, përgjegjës i burimeve njerëzore në Drejtorinë Arsimore etj. Aktualisht mësuës në shkollën e mesme të qytetit.

**2-Çfarë keni shkruar ndër vite? Cila është gjinia juaj e preferuar?**

- Shkrimësia ime është një krisje e shpirtit të hepuar nëpër mote. Kujtesa e mbingarkuar prej gjithfarë ngarkesash dhe fikSIONESH nduk dhe kurdit mekanizmin e pakuptuar të nënvetëdijes, prej nga ndihem i ngacmuar e i shqetësuar. Prej disa vitesh kam botuar tregime, ese dhe publicistikë në shtypin periodik, një pjesë e të cilave u botuan në vëllimin "Përthyerje", prill 2007, libri im i parë. Romani "Pesha e kohës" publikuar nga shtëpia botuese "Toena", doli në dritë më 2008. Në vitin 2009 u botuan libri me proza "Bari i ujkut" nga "Toena" dhe novela "Ëndërrat kryqëzojnë kohën" në dy gjuhë, shqip dhe anglisht nga shtëpia botuese "Ada". Vëllimi me titull "Hapësirat rrallohen prej dhimbjes" është në proces botimi. Preferoj prozën e gjatë dhe romanin.

**3-Jeni një krijues i mirëfilltë në gjininë e tregimit. i vlerësuar nga kritika letrare, së fundi me Çmimin e Tretë dhe lexues të shumtë. Sa qëndron kjo te krijimtaria juaj?**

- Unë thjesht shkruaj. Kam në kokë qindra motive, disa i kam hedhur në letër, të tjerat qëndrojnë në hije. Vesi i të shkruarit është sfilëtës. Shpesh më duket se nuk do të mund t'i realizoj të gjitha prandaj nxitoj. Renditja i treti në konkursin e Tiranës me 60 pjesëmarrës më gëzoj, po nuk janë çmimet që përcaktojnë vlerat. Kriteri objektiv, i pamëshirshëm është koha. Le të kujtojmë që Lasgush Poradeci ende rrethinave të opinionit letrar kur poetë dhe shkrimtarë pa vlerë merrnin çmime dhe përkëdheleshin nga kritika zyrtare e kohës.

**4-Tregimi Juaj, vlerësuar me çmim, "Thikat e Vardarit", stili dhe mënyra e të shkruarit, shprehjet mjaft të goditu-**

Intervistë me shkrimtarin Istref Haxhillari



## Istref Haxhillari sjell në Pogradec çmimin e tretë

Më datën 23 janar u organizua në mjediset e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve konkursi kombëtar i tregimit. Në këtë veprimtari morën pjesë me krijimet e tyre 60 shkrimtarë nga Shqipëria, Kosova dhe Diaspora. Revista letrare e mirënjohur Obelisk pasqyroj gjatë vitit 2009 në çdo numër të saj tregimet e shkrimtarëve të njohur si Fatmir Terziu, Bahri Myftari, Bardhyl Xhama, Skënder Hasko, Klea Vyshka, Odise Plaku, Suzana Kuqi, Raimonda Moisiu etj. Tematika e larmishme e tregimeve, prekjat e problemeve dhe temave të ndryshme si ajo e emigracionit, dashurisë, historisë, korrupsionit i dhanë konkursit ngjyrë dhe peshë. Antologjia e tregimeve të kësaj veprimtari botuar nga Shtëpia botuese ADA i jep lexuesit vizionin e tregimit të sotëm shqiptar, shqetësimet e krijuesve të këtij zhanri të vjetër të letërsisë.

Shkrimtari pogradecar Istref Haxhillari mori çmimin e tretë me tregimin "Thikat e Vardarit".

Autori më i spikatur i prozës së sotme pogradecare dhe më gjerë, Istref Haxhillari që me romanin "Pesha e kohës" jo vetëm pasqyroj artistikisht jetën e vështirë përmes zakoneve, dokeve duke patur për moto dramacitetin e jetës familjare dhe shoqërore të njerëzve të thjeshtë por edhe pikuroi me penelata mjeshtri bukuritë natyrore të zonës së Mokrës dhe Gorës. Guri i Kamjes, piktoresk

dhe madhëstor prej natyre merr në këtë roman përmasat e personazhit me gjak e shpirt si njerëzit krenarë të këtyre anëve. Autori i ka dhënë lexuesit me mjeshtëri artistike peizazhe të mrekullueshme të shkruara me dashuri të madhe për vendin e tij, karaktere të spikatura që nuk mund t'i harrosh lehtë. Me të njëjtën fuqi pene Istref Haxhillari qëndis prozat e vëllimit më të fundit "Bari i ujkut", ku përcjell emociione pikante me vlera të rralla artistike. Në tregimin "Thikat e Vardarit" të këtij vëllimi, fitues i çmimit të sivjetëm, përshkruhet ngjarja dramatike përmes gërshetimit të figurshëm të fjalës krahasuese moderne me frazën elegante plot metafora. Në vështrimin tonë "Thikat e Vardarit" është një kulm i prozës së autorit që fare mirë mund të qëndrojë pranë tregimeve të mjeshtërive të njohur shqiptarë. Filozofia që përcjell tregimin është mallkimi i përhershëm i besëthyerve, pasojat e të cilëve janë më fatale së aktet mizore të kruera prej tyre.

Marrja e këtij trofeu shënon një arritje në prozën pogradecare që i ka fillimet e saj të Mitrush Kuteli, Mirosh Markaj, Luan Starova etj. Përfaqësimi i prozës pogradecare me shumë dinjitet artistik nga Istref Haxhillari në konkursin kombëtar të tregimit rrjedh në vazhden e traditës së mjeshtresë kuteliane, ashtu si poezia e Dhimitër Pojanakut në tragjen e hapur nga Lasgush Poradeci.

Ilir Cane

ra e të bukura, kanë patur jehonë në shtyp dhe internet. Si u lindi ideja për ta shkruar?

- E urrej pabesinë më shumë se çdo ves tjetër. Subjekti i prozës time është motiv i vjetër në letërsi. Kujtoni Shekspirin, krijuesin me të madh të gjithë kohërave. E veçanta e tregimit "Thikat e Vardarit" qëndron në mënyrën si goditet e keqja, llahtari i të pabesëve aq sa vdekja kthehet në shpëtim. Tranzicioni shpalosi akte të shëmtuara të njerëzve tanë brenda dhe jashtë kufijve të vendit. Kapërcyelli shqiptar nuk do të ishte aq i dhimbshëm po të mos masakrohej mizorisht feja, institucionet e saj dhe të krijohet "njeriu i ri", mostër që nuk desh pas Zotit, as prindërit dhe të afërmit. Një rast i tillë i dhimbshëm më ngacmoi të kompozjoja prozën "Thikat e Vardarit".

**5-Gjinia juaj e preferuar është proza, tregimi, romani. A keni shkruar, poezi, reportazhe?**

- Kam shkruar më së shumti ese, reportazhe dhe kritikë, por asnjëherë poezi. Poezia më duket art shumë i lartë, nuk guxoi t'i qasem. Vjershat që kam shkruar në rininë time nuk arritën të bëhen poezi. Nuk e di më vonë. Kam përshtypjen se poezia e sotme është në krizë identiteti, pa nerv dhe emocione të fuqishme që përbëjnë thelbin e poezisë së vërtetë. Edhe proza luhetet në kërkim të formave të reja shpesh pa sukses. Romanet dhe tregimet e njëzet viteve të fundit nuk kanë nxjerrë një personazh të qëndrueshëm, përfaqësues të epokës së tij si Zyllo Kamberi psh. Pa mendoni që Don Kishoti prej 400 vjetësh udhëton nëpër botë i paprekur nga harresa, madje donkishotizmi sot është më i pranishëm se në kohën kur u shkrua.

**6-Shkruani edhe tregime me bazë legjendat. Si ju lindi ideja për t'i shkruar ato, mesazhi që ju transmetoni nëpërmjet tyre?**

- Vendlindja ime luhetet midis duknjës dhe fantazisë si katete të barabarta trekëndëshi këndrejtë. Dheu i Mokrës, hapësirat përreth Liqenit të Ohrit përzihen me vegimet që vërtiten përmes tyre. Nuk dihet në ka më shumë gjallesa apo fiksiione. Imazhet shpërhapen kudo. Ju e dini legjendën e Kadmit dhe Harmonisë, zanafilla e liqenit dhe fisit të lashtë të Enkelejve. Njerëzit e kohëve të shkuara në trojet e vendlindjes sime jetonin mes imazheve, lindnin dhe vdisnin në mjegullnajën e tyre, sklavëruar nga fantazi, që i besonin barabar me gurët e valëzuar dhe pyjet e gjera të vendit.

Kujtesa ka veti përzgjedhëse, fikson e ngulit sjellje, veprime, ngjarje të holla përshtypjelënëse që e tronditin dhe shpërfill të tjera që nuk lenë vragë, të dorës së dytë apo të rastit. Dukuri të pakuptuara për arsye kohëtare, ngacmuese tejgjatë të palarguara asnjë çast, njeriu përpiqet t'i kthjellonte dhe shkoqiste si mundej. Në përpjestim me kufijtë e njohjes dhe përcetimeve të kahershme, dritësimi i ndodhive tejet të dhimbshme mbresëlënëse ishte larg së vërtetës, po brenda përjetimeve njerëzore. Në këtë trajtë u mbartën nga njëri brez në tjetrin, ngjallën habi, gëzim, mburrje apo mosbesim, nënqeshje shpërfillse për zgripin e shpalosjes së tyre nga interpretues të lashtësisë. Shpesh quhen përralla, gënjeshtra që nuk mund t'i pranojë njeriu i kulturuar, ndaj arkivohen në lëmin e trashëgimisë së pancevojshme. Po si ta shpjegojmë jehonën e pambaruar, tingëllimën shekullkapërcyese, trokitjen në kujtesën njerëzore gati përjetësisht?

(vijon në faqen )

Poezi nga Eduart SULOLLARI

# Hëna rrukulliset yjeve

Lumenjtë e ikjes

U zgjuan lumenjtë e ikjes...

Asgjë tashmë s'më tërheq vëmendjen  
se sa një psherëtimë

Brigjeve të kaltra të vetmisë  
Ishuj të rinj zbulojnë sytë

Dru më dru era qan  
Dimëron dhimbja

Bri shëlgjesh floknaja e ndajnatës  
shtrin vellon,  
Ndoshta prek të nesërmen e parë pa të?

Ëndrra e gjelbër  
rrëshqet vragës  
mbytëse të pikëllimit

Gjithnjë e më larg shikimit tim  
Tisi i purpurt i mjegullës  
pushton kullën ku lumturia firoi

Qiejt gri lundrojnë  
si ajsbergë përgjatë ditëve  
pa ty

Bosh zemra:  
oborr ku heshtja e bardhë  
endet cep më cep

Kujtimi i saj  
ngecur rrjetës së dëborërave...

Ulërin dimri  
Ulërin...

Rekuem

Nuk erdhi e bardhë kjo natë...  
Zëri yt xhonglon me ajrin e ngjeshur  
të pishave të pritjes.  
Karrocës së vjetër të trishtimit, hëna  
mbledh yjet.

Qielli i mardhur prehërit të dimrit struket,  
Ndërsa luginës ku hapat e tua kumbuan  
Era e mbrëmjes përplas fluturat e ditës.

Klithma e degëve

Mjegulla hap gojën,  
Ndërsa gjuha shtyn portat e dimrit  
Fusha, liqeni, bregu për matanë  
brenda kafazit  
Një cep rruge zgjatet si qafë lejleku

Harliset shikimi im  
Kërkon përroin e syve të tu.

Klithma e degëve  
Gris letrat e bardha të natës

Rrëzim

Duarve të mia u ul humbja  
Dhimbja pushton horizontet  
Tek portat e perëndive  
Fati im i thyer s'kalit pikëllimin



Thinjen ditët...

Me kryet vënë brigjeve të mallit  
Muzgu i moçëm thyen pragjet,  
Ndërsa vjeshta e vonë  
Përrenjve të vdekur vë kryqe

Hëna rrukulliset yjeve

Aty ku të prita herën e parë  
Dimri qëmton buzë mbrëmje  
Aty tashmë rrezohem gjithnjë  
Aty ku më pret sa herë  
një engjëll i mbrapshtë.

Orët e ndarjes

Shkund borën nga çatia e vjetër  
Trishtimi me sytë prej uji  
E ketrat dru më dru  
Pelerinën e dimrit shqepin.

Korijes së shkretë më vdiq  
Ëndrra e bardhë vizatuar  
Në çerdhen e dimrit  
Dhe shpirti i saj u bë re.

Me gjunjët mbështetur borës  
Orët e ndarjes thërrasin.

Dhimbja, zog që përpin qiejt.


Janë e pazakonta, e lemerishmja, e frikshme e legjendës që udhëtojnë gjatë dhe përimitohen sot njëlloj si dikur, parvarësisht nga meditimet. Prozat e mia me motive legjendash janë ngjizur mbi këtë opus konceptual letrar dhe njerëzor. Po legjendat janë vetëm shtysa. Më tej ka punuar fantazia për t'i kthyer ato në rrëfenja përafërsisht të tipit kutelian.

7- Ç'mund të na thonë për "Iradenë", një tregim jashtëzakonisht i bukur?

- Në shkollën e mesme kam lexuar vlerësimet e Lasgush Poradecit për Nikolla Naçon, një shkrim vërtet brilant. Më ka mbetur në mendje përpjekja titanike e tij për të bërë Shqipërinë në fundin e shekullit XIX. Ishte Naçoja që bleu me flori fermanin e Sulltanit për hapjen e shkollës së parë shqipe në Korçë, mbajti me shpenzimet e tij mësuesit dhe komitetet që e ruanin etj. Mbi këtë motiv madhor kam ndërtuar tregimin "Iradaja", ku gjithashtu fantazia ka punuar shumë. Unë kam futur aty një dashuri të zjarrtë të Nikollës për një rumune, Aleksian, që sigurisht nuk ka ekzistuar ose mund të ketë qenë një tjetër femër me tjetër rrjedhë në jetën e tij prej beqari. Dueli i Nikollës me Damad beun, funksionarin e lartë të Portës është krijesë e imja, jo e vërtetë historike. Në vizionin tim letërsia nuk është fytyra e historisë po ana tjetër e saj, ajo që duhet të kishte ndodhur ndryshe.

8-Si iu duket kritika letrare sot? A ka kritikë të mirëfilltë? Ç'mund të na thonë për këtë temë që shqetëson njerëzit e letrave shqipe?

- Nuk pajtohem me inekzistencën e kritikës siç thuhet shpesh. Kritikë ka por ajo vuan nga mungesa e profesionalizmit dhe një klientelizëm i tejskaj. Me një pagesë modeste kritikë të njohur ngrejnë në pedestal krijime dukshëm të dobëta. Habitesh kur lexon nëpër organe letrare, gazeta apo internet për një Xhojs në Vlorë, Borges të ri në Tropojë e të tjera absurditete. Zoti



na ruajtët nga predikues të tillë.

Po aq i dëmshëm është fetishizimi i figurave të mëdha. Krijuesit e afirmuar rrethohen nga vlerësime dalëmode. Kritikët u thurin lavde në përmasa groteske, më shumë për jehonën e shkuar se veprat letrare që janë dukshëm poshtë lavdisë së dikurshme. Brezi i krijuesve më të rinj shikohet me dyshim dhe mosbesim të pakuptimtë. Situatë jo normale. Mungesa e kritikës profesioniste dhe objektive, analiza rracionale e prurjeve të reja në letërsi, pa paragjykime, pa dalime mendoj se është nevojë po aq e domosdoshme sa një operacion urgjent kirurgjikal në trupin e të sëmurit.

9-Në vështrimin tuaj si ngjizet një veprë letrare?

- Ju cekët linjë delikate paksa fluide, ku druaj se definohet ndonjë rregullsi e pranueshme për të gjithë. Kam përshtypjen se sprovat krijuese nuk hyjnë në të njëjtën hulli, nuk mund t'i binden saktësisht ndonjë ecurie fikse përgjithësuere, njëngjyrëshe.

Plazmimi letrar, ndoshta edhe i traga-

ve të tjera të artit, i ngjan së tepërmi ngjizjes së fëmijës në barkun e nënës. Akti i formësimit në zanafillë është proces i fshehtë brendësor dhe i pakuptuar, s'e di askush veç krijuesve potencialë, madje shansi i pjalmëzimit është i pakapshëm për vetë çiftin ngjizës. Kur duken shenjat e para të shtatzanisë grua e paqartë në fillësën fshehtarake, e pasigurt ngurron t'i shfaqet partnerit të afërt, po kur sigurohet plotësisht i jep lajmin me gëzim të parrëfyer.

Vijmë në pyetjen tuaj të ngjizjes së veprës letrare, përngjasimin me lindjen dhe nxjerrjen në jetë të fëmijës. Tek njeriu i letrave në fillim lind ideja e krijimit, ngasja e së cilës mund të jetë gjithfarësh, mbresë e afërt apo e largët, ngjarje të veçanta ose të zakonata, përjetime fantazie apo ëndrra. Mbresa rri tular thellë nënvetëdijes, herë humbet harrohet për ca kohë, pastaj shfaqet sërish, bëhet ngacmuese dhe tek krijuesit e mirëfilltë arrin kufijtë e torturës. Thonë se Mendelejevit që studjoi për një kohë të gjatë mundësinë e vendosjes së rreg-

ullit në shumëllojshmërinë e elementeve kimike, tabela e sistemit periodik iu përshfaq në ëndërr dhe ai u ngrit e shkroi. Ndoshta mund të jetë legjendë, diçka e zmadhuar, por në thelbin e vet mbart ngacmimin e vazhduar të idesë torturuese përjetuar gjatë.

10- A mendoni se ka një krizë leximi, se mjetet audiovizive kanë zbehur interesin për librin?

- Jo, absolutisht jo. Pranoj që një pjesë e njerëzve të sotëm janë të sipërfaqshëm, mjaftohen me plotësimin e nevojave shpirtërore përmes imazheve audiovizive. Ndërsa libri, pergamenë, letër apo elektronik është mjeti më ideal dhe më produktiv i dialogimit, i pakrahueshëm për nga thellësia as me mikun më të mirë. Letërsisë i kanë mbetur ata lexues besnikë që duhet të jenë. Të tjerët kanë patur lidhje të dobëta me të. Elektronika ka hapur mundësi të mrekullueshme në të shkruar, komoditetet tejet të sofistikuara me perspektivë edhe më të shkëlqyer. Po sido të jetë kibernetika, mbetet një formë më e avancuar e paraqitjes së shpirtit të njeriut dhe vetëm kaq. Ashtu si letra e bardhë nuk të thotë asgjë, kompjuteri dhe interneti mbeten thjesht mjete të vdekur krejtësisht të pakuptimta pa shpirtin e krijuesve të letërsisë dhe artit më përgjithësisht.

10-Cili autor iu inspiron?

Janë disa: Xhojsi, Kafka, Borges, Kuteli, Mjeda dhe më të rinjtë Agron Tufa, Rudian Zekthi, Ardian Kçyçku etj.

11- Së fundi?

- Eshtë impresionuese të shpreh idetë dhe disa krijime të miat në bisedë me ju, znj. Raimonda, poete dhe prozatore e talentuar. Uroj sa më shumë mendje të dlira të bashkohen përreth tempullit të letërsisë, kësaj perëndeshe të përjetshme.

Faleminderit.

Intervisoi: Raimonda Moisiu

(Marrë nga "Fjala e lirë" dhe "Bota e re")

(vijon nga numri i kaluar)

Dëshiroj t'ju besoj një amanet o vëllezër". Të katër bashkuam zërat:

-Çfarë amaneti, Hirësi?

Na pa të katërve, duket nëpër mjegull, fshiu lëngun e kristaltë që i qarkullonte nëpër bebët e syve dhe me buzët që filluan t'i dridhen me gjysmë zëri belbëzo:

-Thashë, jam plak, m'u mbështoll në lëmshin e jetës 83 vjet mundet të më marrë Zoti në parajsë...

-Dushmanin.

-Ja u var amanetin në qafë, s'e pata atë fat ta puthnja tokën e nënës Shqipëri. Mos më lini këtu. Më mirrni e më shpini të më puthë ajo të vdekur, të m'i tretë eshtrat. Ta dinë, po më latë këtu, nuk do m'i tretë kockat, toka amerikane.

U mallëngjyem aq shumë sa na u bukos zëri në grykë. Me një zë të përpëlitur na u drejtua përsëri: „Nëmani fjalën, mos më lini këtu.

Dëshiroj edhe një herë të kujtoj: „S'e putha unë Mëmëdheun, le të më puthë ay të vdekur. Do ta mbani fjalën?" Përsëri të katër e siguroam:

-Amanetin s'e tret dheu.

Vajti ora e nisjes. U ngritëm. E shoqëruam deri në treni. U përqaftuam, s'i mbanim dot lotët.

Duke i hedhur këmbët në shkallët e trenit, ngriti duart lart e me gjithë fuqitë e shpirtit klithi: „Amanetin mos e harroini". I uruam të katërt:

-Rrugën e mbarë e të mirë u takofshim sa më parë në Atdhe.

Buzëqeshi dhe mërmëriti:

-Urimi juaj vaftë në vesh të Perëndisë.

Ne nga traseja e stacionit, ai nga dritarja e trenit përshëndesnim njëritjetrin derisa trenin e mbuloi mjegulla. Kjo ishte ndarja e fundit. I mbarove pyetjet apo ke ndonjë tjetër? I ngashëryer, iu luta të kujtoja diçka që më kishte mbetur peng në shpirt:

-Rastësisht duke dëgjuar radion „Zëri i Amerikës", jam i saktë, korrik 1962, jepte lajmin se „Qeveria amerikane i jepte lehtë Nolit të vinte në Shqipëri për të siguruar një despot shqiptar mbas vdekjes së tij dhe i kishte dhënë lehtë, po të deshte të qëndronte për gjithnjë në Atdheun e tij". Si ka qenë e vërteta? Kujtoj që më dha këtë përgjigje:

-Mos i beso gënjeshttrat e imperializmit amerikan. Beso të vërtetën

që thotë shoku Enver dhe partia jonë. Tomi, po të tregoj një fakt tjetër: Në mars të vitit 1955, megjithëqë s'kishim marrëdhënie diplomatike, presidenti SHBA, Duajt Ajzenhauer, i ofroi Shqipërisë një ndihmë prej 850.000 dollarësh (në drithë e sende ushqimore). Mora telegramin dhe i vajta shokut Enver në Durrës. Përfundimisht, ai më tha: „Ky propozim është thjesht një propozim propagandistik, prandaj nuk duhet pranuar".

-Në atë kohë foli shtypi, i thashë



Noli dhe B. Shtylla

## AMANETI

Sipas bisedave me mikun tim, të ndjerin Behar Shtylla nga TOMI MATO

Beharit: „Qeveria ndihmën e refuzoi". Vura re që shoku Behar pa orën. Kisha ankthit, problemin kryesor që më qëndronte në zemër për problemin e Nolit.

-Jam i saktë, më 15 mars 1965

Agjencia Telegrafike Shqiptare dha lajmin: „Pas një sëmundjeje të rëndë, në qytetin Lauderdale të Floridas, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në moshën 83 vjeçare, vdiq Mitropoliti Fan S. Noli". As Radio Tirana, as shtypi i partisë, „Zëri i Popullit", apo ai i Frontit Demokratik, „Bashkimi", nuk shkrojtën ndonjë artikull për këtë demokrat revolucionar, apo të organizonin ndonjë mbledhje të Kuvendit Popullor, siç u organizua për „Baba Stalinit". Kur flisja, kisha ndjesinë se në atë kohë shoku Behar ishte ministër i Jashtëm. Më dëgjoi me ndjenjën e trishtimit.

Kisha krijuar bindje se kishte respekt të madh për Nolin. U trazua në ndërgjegje dhe nuk m'u përgjigji. Mendova se rikujtohe një mëkat që ishte bërë nga partia, ndaj dhe i drejtova pyetjen:

-Shoku Behar, vajtë në varrim?

I brengosur më informoi:

-I dërgova fjalimin që do mbahej nga shoku Halim Budo, por as atij s'i dhanë vizë. Fjalën e mbajti një nga miqtë tanë. Ceremonia u organizua në varrezat e Forest Hills, në Boston më 20 mars, por tru-

pi i tij nuk u varros...". Kërceva:

-Pse?

-Siç e di, ai e la amanet: „S'e putha tokën mëmë sa isha gjallë, më shpini të më puthë ajo e të m'i tresë eshtrat të vdekur".

I emocionuar dhe i ngashëryer kërkoja:

-Pse s'iu plotësua amaneti? Juve ia dhatë fjalën.

Shëmërtiu dhe informoi:

-Faji s'ishte i yni, ishte i qeverisë amerikane, ajo nuk e lejoi.

-Do vijë dita ta zbardhin këtë krim të qeverisë amerikane brezat e ardhshëm.

Ideja e mikut tim Behar Shtyllës më gudulisi të nënqesh me mëdyshe.

Më ngacmo:

-Tomi, nga fytyra më duket sikur s'je dakord me mendimin tim. Po të kesh dëgjuar ndonjë të vërtetë tjetër, mos u ndruaj. Mirëkuptohemi bashkë.

Fol me zemër në dorë. Gjithçka që do më tregosh do shkrihet këtu si tymi duhanit. Vendosa dhe i thashë:

-Në lagjen time, aty nga viti 1971 u riatdhesua një pogradecar, Vangjel Kapbardhi. Amerika ia kishte shtrydhur energjitë fizike, por kujtesën e kishte enciklopedi historike. Midis të tjerave, mendja më rrinte tek amaneti i Nolit. E pyeta:

-Xha Vangjel ceremonia e varrimit të Nolit u bë në Boston më 20 mars 1965, ti

i dhe lamtumirën e fundit Mitropolitit të Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare?

-Jo. Po televizori, radioja, gazetë folën shumë, veçanërisht „Dielli". I kërkoja:

-Kujton ndonjë gjë interesante që të ngjall dhimbje, ç'u tha dhe ç'u shkrua? Nuk u mendua, përgjigjen e kishte në buzët, e nxori ankthit:

-Dy mëkate që iu bënë amanetit që Noli madh i kishte lënë me gojë, i kam varur, si thonë fjalës, vëth në vesh. Do të t'i tregoj, o çuni i Spase Thimo Matos?

-Të lutem me dorë në zemër, tregomi.

Shëmërtiu, filloi të qarkullojë një lëng i kristaltë nëpër kokërdhokët e syve, i fshiu me kurrizin e dorës së djathtë e filloi.

-U shkrojt nëpër gazeta se qeveria shqiptare kishte dërguar një fjalim që të lëçitej ditën e varrimit. E lexoi një dhespot. Midis të tjerave tha:

„Hirësia e tij, Fan Stilian Noli, e la me gojën e tij t'ia shpinin trupin në mëmëdheun e tij, Nënë Shqipëri".

Që ta dish ti, aa vdiq më 13 mars dhe ceremonia u bë më 20 mars

1965. Trupi nuk u varros. Këshilli i Peshkopëve i dërgoi qeverisë shqiptare një letër ku i shkruante:

„Në rrethanat e tanishme është e pamundur të sjellim trupin e atdhetarit të madh. Këtë amanet dhe nder shpresojmë ta bëjmë në një kohë sa më të afërt.

Behari më dëgjoi me shumë vëmendje.

Më kërkoi:

-Problemin e parë e mësova po problemi i dytë ç'të tha?

-Mëkati dytë ishte ky: Kolonia shqiptare priti dhe priti 5 vite, 6 muaj, e 4 ditë, e ruajti trupin e ngrirë të Nolit në një stabiliment të specializuar, por nuk pranuan ta shpinim.

Kërshëria më nxitu ta zhbiroj, pa u hodh shoku Behar:

-Për faj të qeverisë amerikane.

Duke luajtur kokën sa majtasdjathtas thashë:

-Xha Vangjeli më tha, për faj të partisë e mbretit të Shqipërisë, Enver Hoxhës.

Shoku Behar u zvodhit në fytyrë.

Kujtoj që ma tha:

-Tomi, miku im, mua kështu më thanë, kështu thashë. Historia do ta zbardhë... Për mua problemi u zbardh: „Amanetin" që dha demokracia për revolucionar shqiptar në qershor të vitit 1924, s'e bëri realitet diktatura, atë do ta realizojë epoka e ndritur e demokracisë. Noli do vijë në Atdhe, e la me gojën e tij: „Ta puth të vdekur e të m'i tresë kockat Nëna Shqipëri". Populli do t'i shpjerë lule më 13 mars.

Pogradec, 2 nëntor 2009



## NUK ARRESTOHET POETI KOMBËTAR LASGUSH PORADECI

(vijon nga faqja 7)

Kështu ia punova. Ama, Lasgushi s'e uli kokën.

Një herë tjetër ishim në klubin e shkrimtarëve, kur Lasgushi më rrëfeu një ngjarje që o kish ndodhur gjatë ditëve të fundit të Luftës Tiranës, në nëntor 1944. Një pasdreke vonë, kish dalë të shëtiste. Lagjia e tij ishte çliruar nga partizanët dhe poeti mezi e mbante ngazëllimin e lirisë aq shumë të dëshiruar.

Megjithëse dëgjoja të shtëna, që binin në pjesën tjetër të Tiranës, -trgonte Lasgushi, -unë barisaj. As që doja t'ia dija. Këtë ditë e kisha pritur. Veç kur dëgjoi thirrjen „Ndal". Ngre sytë. Një patrullë partizane qëndronte mu përballë meje. Zëri i tyre ishte i ashpër, zë lufte. Dys-honin, ç'doja unë ashtu me bastun e republikë në kokë, si një borgjez i vërtetë, që sillesha vërdallë. Ua shpegova, po atyre nuk ju mbush mendja, më vunë në

mes dhe më çuan drejt e në shtabin e madh partizan. Atje komandant ishte Mehmet Shehu. Unë nuk e njihja po ai më njihje. E njihje poetin prandaj sa më pa, u ngrit në këmbë. Më dha dorën me respekt dhe me uli në krye te vendit. Pastaj thirri patrullën partizane dhe me një zë të hakërruar i pyeti: „Ç'keni bërë kështu more shokë, ç'keni bërë?" Ata hapen syte. „Po arrestohet poeti kombëtar Lasgush Poradeci. Turp të keni. Pastaj mu kthye mua në muhabet. Bobo, ajo fytyrë e ashpërsuar nga lufta, me tërë ato armë në brez, erdhi e pastaj u zbut. E

zbuti Lasgushi, që deshte paqe dhe dashuri kombëtare. Në fund i urdhëroi partizanët: „Kërkojeni ndjesë shokut Lasgush dhe e çoni drejt e në shtëpi me xhips" dhe më zgjati dorën si burri burrit. Partizanët e shkretë, të turperuar, nuk dinin sit ë shfaqësoheshin. Po unë u thashë: „Bravo, djema, se ju bëtë detyrën që u takonte". Kur u ndamë te porta e shtëpisë, ku kishte dalë Nafija, gruaja e shkretë, gjithë merak e më priste, partizanët më nderuan me grusht. Kështu i ngjau Lasgushit.

Nga Nasho JORGAQI

### Gazeta "Mokra" në Internet

Që nga numri 111 gazeta "Mokra" ka dalë në internet, ne adresën e mëposhtme:

[www.poradeci.com/mokra](http://www.poradeci.com/mokra)

Tashmë edhe mokraret që nuk banojnë në Shqipëri do të kenë rastin të shikojnë në internet gazetën e përmuajshme "Mokra".